

**PROGRAM VJETOR**

**PËR PUNËN E INSTITUCIONIT KOMUNAL PUBLIK PËR FËMIJË – KOPSHTI  
PËR FËMIJË “Snezhana ” Çair- Shkup**

**2021/2022**



**Shkup, Shtator 2021**

**Nëse bëni plane për dhjetë vitet e ardhme mbillni një dru. Nëse bëni plane për një qind vitet e ardhme, mësoni fëmijët**

### Hyrje

*...Arsimi duhet të orientohet drejt zhvillimit të tërësishëm të personalitetit dhe drejt ndërtimit të respektit për të drejtat dhe liritë e njeriut. Kjo duhet të promovojë mirëkuptim, tolerancë dhe miqësi*

*Deklarata universale për të drejtat e njeriut, Neni 26.2*

Në disa dekadat e fundit, si asnjëherë më parë zhvillimi i hershëm i fëmijëve ka në dispozicion një kujdes të veçantë dhe shumë vende kanë vënë qëllime ambicioze që ta përmirësojnë kualitetin dhe kuantitetin e zhvillimit ét hershëm të fëmijëve si dhe qasjen deri në arsimin parashkollor të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Arsimi dhe edukimi parashkollor janë veprimitari me interes të veçantë shoqëror dhe paraqet pjesë themelore të procesit edukativo – arsimor. Zhvillimi është një proces i ndryshimit që ndodh si rezultat i pajtueshmërisë me karakteristikat individuale të fëmijës, monitorimin e forcave të saj të brendshme dhe zhvillim të natyrshëm në të cilën fëmija i forcon dhe rrit aftësitë e tij në lëvizje, të menduarit, ndjenjat, të folurit.

**Principet themelore të Programit janë:** Parimin e mundësive të barabarta, respektimin e dallimeve, multikulturalizmin, qasje të barabartë në arsimim cilësor për çdo fëmijë, parimi i hapur i procesit edukativo-arsimor, mësimdhënien e individualizuar, qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin e fëmijës, një metodologji që është e drejtuar ndaj fëmijëve, përfshirjen e familjeve dhe komunitetit, duke përdorur një shumëlojshmëri të metodave të të mësuarit dhe duke krijuar një mjeshtësim stimulues e cila ndër të tjera e pasqyron kulturën prej nga edhe rrjedhin fëmijët.

Institucioni parashkollar siguron kushte për përbushjen e nevojave të fëmijës që burojnë nga natyra e tyre: të socializohet dhe të afirmohet; mësimi nëpërmjet lojës, ndërveprim (fëmijë-fëmijë, fëmijë- i moshuar) përfshirja aktive në kërkimin dhe proceset e zbulimit dhe zgjidhjen e situatave të ndryshme të problemeve nga ana e secilit fëmijë, për të inkurajuar zhvillimin mendor dhe fizik; të pasurohet të folurit e tij dhe të përqendrimit të tij sensibilizuese - përvojë emocional; për të krijuar një kulturë - dhe shprehëtë higjenike të punës dhe aftësive; për të përbushur nevojat e fëmijës për lojë dhe të kontaktojnë me moshatarët dhe me të rriturit, dhe të zhvillojnë potencialin individual krijues.

Veprimtaria edukative – arsimore dhe e kujdesit të institucionit publik për fëmijë – Kopshtin e fëmijëve “Snezhana” programohet, organizohet dhe realizohet në bazë të:

- Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (“Gazeta Zyrtare” e RMV nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/181, 04/19)
- Programi për mësim të hershëm dhe zhvillim (“Gazeta Zyrtare” e RMV nr. 22/13 dhe 12/14 të datës 06.03.2014
- Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm tek fëmijët prej moshës 0 deri më 6 vjeçare
- Statuti i IPKKF “Sbezhana”, komuna e Çairit, Shkup
- Dokument i përpiluar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të Republikës Maqedonisë së Veriut dhe zyra e UNICEF;
- Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
- Kushtet të cilat i siguron kopshti për fëmijë për realizimi e qëllimeve, detyrave dhe përmbajtjeve programore
- Njohuri më të reja shkencore, pedagogjike – psikologjike për potencialet zhvillimore dhe intelektuale të fëmijëve;
- Kalim human në kuptimin e natyrës së fëmijës dhe zhvillimit të tij fizik dhe shpirtëror, si qenie njohëse dhe sociale
- Përvojat pozitive të IPKKF “Sbezhana” për veprimtarinë përkujdesëse dhe edukativo-arsimore

Planifikimi dhe programimi janë në funksion të avancimit të udhëheqësisë sepse nëpërmjet të tyre mundësohet lidhja funksionale dhe efikase e njerëzve, mjeteve materiale dhe resurseve tjera me qëllim për realizim të suksesshëm të qëllimeve dhe detyrave të veprimtarisë të përkujdesit, edukative dhe arsimore të institucionit.

Programi është i përgatitur sipas tezave dhe drejtimeve nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë për Punë dhe Politik Sociale.

## **Bazat dalëse për organizimin e veprimitarise**

- Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm

Bazat dalëse për miratimin e Programit vjetor për punë të Kopshtit të fëmijëve për kujdesin, edukimin dhe arsimimin “Snezhana”. Çair, Shkup për këtë vit janë:

- Struktura programore për veprimtarin edukativo- arsimore dhe kujdesen së bashku me planet dhe programet për grupin .
- Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm
- Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm.
- Programi për edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore ne qendrat për përkujdes dhe edukimin e fëmijëve , me procesin e mirëmbajtjes dhe ushqim i shëndetshëm

Në aktivitetin e gjithëmbarshme Kopshti i fëmijëve do të bazohet në rregulloret ligjore për veprimtari.

### **1. Bazat mbi të cilat është përgatitur Programi Vjetor**

Fëmijëria e hershme është e rëndësishme në zhvillimin e tërësishëm të personalitetit. Teoritë dhe hulumtimet tërheqin vërejtjen mbi rëndësinë e fëmijërisë së hershme për zhvillimin fizik, intelektual, emocional dhe social e me këtë edhe mbi rëndësinë e organizimit të krijimit të kushteve për atë. Secili fëmijë ka kapacitetet dhe potencialet e tij të cilët në mënyrë permanente duhet ta frymëzojnë dhe zhvillojnë. Aktivitetet zhvillimore te secili individ-fëmijë paraqesin imperativ për nevojën e njohjes dhe mësimit nëpërmjet të lojës, interaksionit, aktivizim në proceset hulumtuese-zbuluese dhe në zgjidhjen e situatave problematike nga ana e secilit fëmijë.

Vështrimet profesionale-shkencore tërheqin vërejtjen në atë se gjashtë vitet e para të jetës së njeriut janë fondament i edukimit dhe arsimimit të secilit individ. Sipas detyrë themelore në punën me fëmijë do të jetë thellimi i të gjitha aktiviteteve të cilat janë: kujdes me kualitativ, edukim arsimor, para së gjithash krijimi i kushteve stimuluese për zhvillimin e fëmijës dhe zhvillim të anëve të tij pozitive dhe potencialeve krijuese. Edukimi dhe arsimimi mirë i organizuar i fëmijëve nga mosha parashkollore paraqet koncept që duhet të bazohet në principe të qarta dhe të mira si dhe saktë precizuara për shkak se ky segment i edukimit dhe arsimimit të fëmijës është me interes të madh shoqëror.

- principi i demokratizimit (ofrohet zgjidhje e madhe e aktiviteteve);
- principi i hapjes së procesit edukativo-arsimor (drejt të gjitha institucioneve në të cilat fëmija jeton, lëviz dhe komunikon);
- Parimi i dominimit të lojës (ajo ndihmon zhvillimin fizik të fëmijëve);
- Parimi i të mësuarit aktiv dhe respekt për mënyra të ndryshme të shprehjes;
- principi i mundësive të njëjta dhe principi i multikulturalizmit (respekti ndaj dallimeve të fëmijëve);
- parimi i përputhshmërisë (nga tipare të moshës dhe aftësive);
- Parimi i monitorimit dhe zhvillimit inkurajuese fëmijëve;
- parimi i tërësisë dhe integritetit;
- Parimi i zhvillimit - një qasje procedural;
- Parimi i individualizimit;
- principi i vlerësimit kritik (evalvimi).

Për avancimin e kualitetit e punës edukative arsimore Kopsht do të përkushtohet drejt realizimit të qëllimeve dhe detyrave në vijim:

- Në pajtim me mundësitë e veta të sigurojë kushte optimale për zhvillim normal, fizik, intelektual, emocional dhe social të fëmijëve nga mosha 0- 6 vjet;
- Të sigurojë kushte për funksionimin e sistemit unik të punës edukativo-arsimore, kujdes, ushqim, mbrojtje shëndetësore dhe sociale;
- Të sigurohet zbatim më kualitativ i programit për punën edukativo-arsimore;
- Të sigurohet edukim i vazhdueshëm i kuadrit profesional;
- Avancimi dhe pajisja e hapësirës së mbyllur dhe te hapur në të cilat qëndrojnë punojnë dhe jetojnë fëmijët, ndërsa njëkohësisht bëhet avancimi i kushteve për punë për të gjithë të punësuarit në Kopsht;
- kujdes dhe pasurim i krijimtarisë së fëmijës dhe aftësim për shprehje të të folurit dhe zhvillimit të aftësive për komunikim, shprehjet e artit dhe figurative dhe muzikore nëpërmjet të lojës dhe aktiviteteve të tjera;
- zhvillimi intelektual, emocional dhe social i fëmijës;
- kujdes dhe pasurim i krijimtarisë së fëmijës dhe aftësi për shprehur të folurit dhe zhvillimi i aftësive për komunikim, shprehjet e artit dhe figurative dhe muzikore nëpërmjet të lojës dhe aktiviteteve të tjera;
- përfitim me dituri themelore, shkathtësi dhe shprehi, zhvillim i vetëdijes te fëmijët për përgjegjësi shoqërore dhe inkuadrim aktiv në jetën shoqërore,zhvillim i kuptimit për pranim, përjetim dhe vlerësim të vlerave estetike, ndërtim të raporteve

humane ndërmjet gjinive dhe raport të drejtë përball mjedisit jetësor dhe përgatitje të fëmijës për vazhdimin e arsimimit në shkollë filllore.

Konform akteve ligjore, programet dhe aktivitete plotësuese do të mundohemi ta realizojmë qëllimin bazë të Kopshtit, e ajo është kujdesi, përkëdhelja, ushqimi, edukimi, arsimimi, aktivitete sportive -rekreative, kulturore -zbavitëse, masat dhe aktivitet për përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit të fëmijës, si dhe aktivitete që kanë për qëllim ta frymëzojnë zhvillimin intelektual, emocional, moral, fizik dhe social te fëmijët.

## 1. Kushtet për punë dhe vendosja organizative

### a) Kushtet hapësinore

Institucioni Komunal Publik për fëmijë –Kopshti për fëmijë “Snezhana” ka dy objekte në:

- NJP „Shkurtabiçët“ – objekti amë në rr. „Xhon Kenedi“ nr. 1.
- NJP „Fjolla“ – rr. „Nikola Grçeto“ nr. 3

Objektet janë të ndërtimit të fortë në të cilat ekzistojnë kushte solide, arkitektonike, pedagogjike, shëndetësore – higjenike për punë. Në korniza të territorit të komunës së Çairit, në mënyrë hapësinore nuk janë shumë të larg njëra tjetrës, e cila siguron komunikim të lehtë dhe të përafërt për organizimin e të gjitha proceseve të punës në realizimin e qëllimeve dhe detyrave programore.

Kushtet hapësinore dhe përfshirja e fëmijëve sipas objekteve janë dhënë në tabelat në vijim :

Nr. rend	Objekti	Kapaciteti i projektuar	Përfshirja e fëmijëve		Gjuha në të cilën realizohet puna edukative - arsimore			Gjithsej
			Cerdhe	Kopsht	maqedonase	shqipe	turke	
1	N.J.P. „Shkurtabiçët“	180	28	155	133	50	/	183
2	N.J.P. „Fjolla“	190	26	215	47	178	16	241
3	Gjithsej	370	54	370	180	228	16	424

Për arsyet e gjendjes së re të krijuar me pandeminë të shkaktuar nga Kovid 19, në pajtim me Protokollet dhe rekomandimet nga KSN dhe MPPS, numri i fëmijëve të cilët duhet të kujdeset në grupe, në mënyrë drastike është zvogëluar e përkëtë arsyet edhe numri i grupeve, struktura e fëmijëve në të njëjtët do ta përshtatim sipas gjendjes përmomentin e fillimit me punë të kopshteve në tërë Republikën. Gjithsesi do të mundohemi që ti respektojmë të gjitha rekomandimet por edhe të ju dalim në ndihmë nevojave të prindërve.

Që të mos ketë mosmarrëveshje me prindërit, përpiluan rregullore me kriterë për përcaktimin e fëmijëve veç më të regjistruar në kopsht, ndërsa prindërit e të cilëve duhet që patjetër ta kryejnë punën në vendin e tyre të punës, por edhe për pranimin e fëmijëve të rinj nëse kemi kapacitet në objektet që kur do ti përcaktojmë fëmijët të cilët i përbushin kushtet.

Gjate regjistrimit te fëmijëve ne vitin shkollore 2021/2022 komisioni u përbajt në udhëzimin e protokolleve përmrundur për punë të kopshtit, të miratuar nga Qeveria e RM të Veriut. Regjistrimi i fëmijëve behet edhe gjate viti shkollor dhe te njëjtët shpërndahen në grupe përkatëse nëse ka vende të lira në kuadër të numrit të paraparë në Ligjin përmrundur e fëmijëve si dhe numri i paraparë me protokollet përmrundur. Nëse Këshilli i komunës së Çairit e voton propozimin e Këshillit Drejtues përmrundur zgjerimin e kufizuar të kapacitetit të kopshtit, do të kemi mundësi që ta risim numrin e fëmijëve të regjistruar në grupe në bazë të vendimit të qeverisë përritjen e numrit prej 20 në 25 fëmijë në grup. Në këtë mënyrë do të ruhen protokollet dhe njëkohësisht do tu dilet në ndihmë prindërvë fëmijët e të cilëve janë në listën e pritjes.

**Objekti „Shkurtabiqët“** është objekt me ndërtim te fortë i ndërtuar me përcaktim dhe i pajisur. Objekti ndodhet në afersi të madhe të SHF "Vasil Glavinov" me gjithsej 1800 m<sup>2</sup> dhe 3600 m<sup>2</sup>. Objekti ka në dispozicion 10 argëtimore dhe në të punojnë 45 të punësuar, ndërsa janë të përfshirë 220 fëmijë.

Objekti ka funksion bazë, qëndrimin tërëditor të fëmijëve në moshë prej 8 muajsh deri në nismë në shkollë fillore, ndërsa përkëtë dedikim i përban edhe hapësirat e nevojshme: hyrje, korridor në hyrje, sallë përmes manifestime, gardërobë, dhoma loje, tualete etj.

Në këtë objekt janë vendosur edhe hapësirat ekonomike, kuzhina qendrore, larësja, tharësja dhe të tjera hapësira të nevojshme, ambulanca, shërbimi i përbashkët administrativ të cilat pa vështirësi i shërbjejnë objektet e tjera në përbërje të Kopshtit. NJP „Shkurtabiqët“ ka në dispozicion sipërfaqe me oborr të madh e cila shfrytëzohet përmes aktiviteteve dhe shëtitjeve me fëmijët m<sup>2</sup> dhe 3600 m<sup>2</sup> sipërfaqe oborri.

Oborri është rrethuar, por nuk është tërësisht nga të gjitha anët. Nga ana e SHF Vasil Glavinov ka një pjesë e cila nuk është e rrethuar dhe kjo krijon problem shëtitjeve me qendrore, qëndrimin tërëditor të fëmijëve.

edhe pse nuk i çojnë fëmijët në kopsht. Po ashtu shpesh ndodh që në oborr të hynë dhe të parkohen automjete si nga ana e prindërve të fëmijëve të kopshtit po ashtu edhe nga shkolla. Në këtë mënyrë bëhet bllokimi i hyrjes dhe ndalesë ndërsa i njëjt duhet përherë të jetë i lirë për nevojat e kopshtit. Po ashtu edhe shtegu i asfaltuar nga vjetërsia dhe shfrytëzimi i tij tejmase tërësisht është gropuar dhe me gropë, gjë që në mënyrë plotësuese e vështirëson lëvizjen e automjetit zyrtar për nevojat e kopshtit. Për këtë qëllim me rëndësi prioritare është që i njëjtë të rinohet me beton dhe asfalt të ri.

Nga aspekti i sigurisë së objektit i njëjtë shpesh herë në orët e vona vizitohet nga persona të rinj të cilët mblidhen dhe bëjnë dëm. Shkatërrohet fasada, e njëjtë ngjyroset, grihet por edhe ndizet. Nga ana jonë për këtë qëllim janë vendosur kamera në vende të caktuara si dhe ndriçim senzorik nate në një pjesë të oborrit që i njëjtë të mbrohet. Me këtë është zvogëluar frekuentimi i natës i njerëzve dhe rreziku nga çfarëdo dëmi, por nuk është e mjaftueshme. Për këtë qëllim do të ishte mirë që komuna të kërkojë nga stacioni më i afërt policor të ketë patrulla nate rreth kopshtit. Në këtë drejtim kopshti në mënyrë permanente do të vazhdojë në rregullimin e oborrit dhe sigurimit të tij, që të mundet i njëjtë të mirëmbahet dhe të shfrytëzohet për nevojat e fëmijëve dhe kopshtit.

**Objekti „Fjolla“** është objekt me ndërtim fortë i ndërtuar me përcaktim dhe i pajisur, i lokalizuar në afërsi të madhe të SH.F. „Rajko Zhinzifov“ ndërmjet banesave banuese. Objekti ka në dispozicion 1800 m<sup>2</sup> dhe 10.000 m<sup>2</sup> sipërfaqe oborri. Objekti disponon me 11 dhoma loje, janë kujdesur fëmijë dhe 34 të punësuar. Në të ka kushte të mjaftueshme administrative, pedagogjike dhe mjekësore dhe higjenike për fëmijë me qëndrim ditore nga 0 muaj deri në shkuarje në shkollë.

Dy klasa të cilat iu dhanë në shfrytëzim SHF Rajko Zhinzifov i janë kthyer për nevojat e kopshtit. Ato janë lëshuar në përdorim dhe në to funksionojnë edhe dy grupe të reja. Të njëjtët duhet në mënyrë plotësuese që të rinovohen dhe rinothen me inventar dhe pajisje të re që ti përbushin kushtet për qëndrim të fëmijëve nga mosha parashkollore.

Po ashtu në objekt është vjetësuar rrjeti i ujësjellësit, këndet sanitare, enterieri (tavolinat, karriget, gardërobat e fëmijëve, dollapët e tjerë) të cilat, nëse marrim mbështetje financiare nga komuna e cila është themeluese e jona, do të mundet të përtërihen. Ne si kopsht do të vazhdojmë të rinojmë pjesë pjesë sa na janë mundësítë financiare.

Gjatë ndërtimit të objekteve nuk është kryer tërësisht ndërtimi dhe pajisja e strehimoreve për të cilat ka proces verbale nga organet kompetente, ndërsa Kopshti i fëmijëve atë në mënyrë të pavarur nuk mund ta kryejë.

Vendi i oborrit i kopshtit nuk është rrethuar në mënyrë përkatëse gjegjësisht rrethoja është demoluar nga kalimtarët e ndryshëm lokal dhe në këtë mënyrë e

njëjtë nuk është siguruar as për fëmijët e as për prindërit as edhe për të punësuarit. Për këtë arsyе vendi i oborrit në këtë objekt është në “dispozicion” të secilit kalimtarë rasti nga banorët lokalë. I njëjtë çdo ditë është eksponuar në hedhje të materialit të llojlojshëm të mbeturinave, shkatërrimin e sipërfaqes gjelbëruese, tubimi i adoleshentëve dhe sjelljeve delikuente.

E gjithë e shënuara më lartë e vështirëson mirëmbajtjen e saj, e zvogëlon sigurinë e objektit dhe të gjithë shfrytëzuesit e të njëjtët. Dhe gjithsesi është qëllim i kujdesit të arsyetuar dhe kritika nga të gjitha palët e prekura. Problem,i i lartpërmendur nuk është zgjidhur, oborri edhe më tutje është në gjendje relativisht të keqe për arsyе se nuk është rrrethuar. Rrethimi kërkon mjete të mëdha financiare të cilët ne vet nuk mundemi që ti sigurojmë.

Vitin e kaluar 2020/2021 ishim cak i shumë zhvillimeve dhe vjedhjeve, demolim dhe thyerje të dritareve nga bërësit e panjohur. Dëmet vet i kemi sajtar. Për të njëjtët gojarisht dhe me shkrim janë njoftuar të gjitha institucionet kompetente. Nëse vazhdon ky problem do të duhet të gjendet zgjidhje për të njëtin nga lloji i vendosjes së grilave të dritareve, rritje e ndriçimit me reflektorë në orët e vona të natës dhe gjithsesi vendosja e lartpërmendur e rrrethojës dhe rrrethimit të plotë të oborrit do të ishte zgjidhje afatgjate.

Problemi i lartpërmendur nuk është zgjidhur, oborri edhe më tutje është në gjendje relativisht të keqe për arsyе se nuk është i rrrethuar. Rrrethoja kërkon mjete të mëdha financiare të cilat ne vet nuk mundemi ti sigurojmë.

Në plan është që të gjenden mjete dhe donacione, që zgjidhet i tërë problemi përhershëm dhe komplet i oborrit.

Oborret në korniza të mundësive në mënyrë maksimale shfrytëzohen përherë kur lejojnë kushtet për realizimin e lojërave në ajër dhe shëtitjet si faktor natyror për zhvillimin e shëndeti të fëmijëve. Veçanërisht tash në kohën e pandemisë, është e dëshiruar dhe e rekomanduar fëmijët çdo ditë të nxirren jashtë, që më pak të jenë në hapësirë të mbyllur e me këtë do të ishte realizuar masa për parandalimin dhe zgjerimin e virusit Kovid 19. Po ashtu qëndrimi në vend të hapur, në cilëndo kohë të vitit është me rëndësi vitale për shëndetin e fëmijëve, me çka do të kishte kontribuar për përforcimin e imunitetit të përgjithshëm si dhe për zhvillim të plotë psiko fizik. Megjithatë siç theksuam edhe më parë, oborri i objektit Fjolla nuk është siguruar nga shkaqet e lartpërmendura dhe i njëjtë nuk mundet të shfrytëzohet çdo ditë. Për këtë arsyе përsëri deri te themeluesi jonë, ndërsa ajo është komuna e Çairit, të na ndihmojë finansiarisht që ta zgjedhim këtë problem i cili zvarritet me vite.

Mund të konstatohet se vitin e planifikuar programor institucioni do ta nisë me kushte solide për qëndrim të fëmijëve me ushqim qendoror dhe shërbim të përbashkët administrativ. Është kryer dezinfektimi dhe dezinfektimi në të gjitha hapësirat në pajtim me protokollet për punë të parapara dhe të miratuara nga Qeveria e RMV. Po ashtu në lidhje me protokollin dhe kushteve për të është vepruar dhe me kojë janë

siguruar termomerë pa kontakt, mjete dezinfektuese, maska për personelin dhe dorëza për punë. Është bërë rirregullimi i hapësirave për qëndrim me renditje të re të tavolinave dhe krevateve ndërsa janë reduktuar edhe grupet sipas numrit me maksimum 20 fëmijë në grup në moshë prej 2-6 vj. Grupet e çerdheve në fillim u kufizuan në 6 fëmijë në grup, që me masën e re qeveritare ai numër është rritur në 12 fëmijë në grupin e çerdheve prej 0 deri më 2 vjet. Protokolli i gjithëmbarshëm është dorëzuar deri te të gjithë të punësuarit në formë të printuar dhe të njëjtët patjetër të veprojnë sipas tij. Për çka rregullisht kryhet mbikëqyrje dhe kontroll nga ana e udhëheqësve, punëtorëve profesional dhe drejtorin.

Në kuadër të këtyre masave, janë formuar të gjitha grupet edukative të fëmijëve gjatë së cilës nga të gjithë fëmijët e regjistruar, përparësi iu dha fëmijëve me dy prindër të punësuar dhe fëmijë të prindërve të punësuar vetushqyes. Tash për tash ky kapacitet është i plotë, por edhe më tutje dorëzohen vërtetime të reja nga prindërit fëmijët e të cilëve nuk janë përkujdesur.

Objektet janë prej ndërtimit të fortë dhe janë të inkuadruara në sistemin e ngrohjes së qytetit të Shkupit – Shkup Veri për te cilat mjete financiare siguron Komuna e Çairit.

Kopshti e fillon vitin programor me pajisje solide të etazheve në grupet edukative me mjete lojërash dhe didaktike të cilat Gjatë vitit në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas nevojës plotësohen dhe pasurohen. Këtë vit vazhdon pajisja me mjete audio-vizuale dhe ndihmesa teknike në të gjitha objektet në pajtim me mundësitë dhe mjetet financiare me të cilat disponon kopshti, duke pasur parasysh se këtë vit kemi rrjedhë të dobët të fëmijëve dhe pagesë të dobët nga fëmijët të cilët mbahen si të regjistruar ndërsa nuk janë përfshirë me masa dhe nuk i sjellin në kopsht. Gjatë kohës së periudhës verore në të gjitha objektet është kryer regjistrimi i literaturës së plotë në bibliotekë e cila vitin e kaluar në vazhdimësi u pasurua me literaturë të re profesionale dhe doracak për punë me fëmijë. Ajo vazhdimësi vazhdon edhe vitin e ardhshëm 2021/2022.

Institucioni ka bërë parapagesë për revistën “Prosvetno delo” dhe “Eduka Mak” për shkak të përbajtjeve më të pasura dhe rregullshmërisë së pajisjeve me dhe përkrah tyre furnizohemi me revistën „Rosica” dhe „Qesharaku,,. Këto revista rregullisht dorëzohen në secilin grup secilin muaj dhe janë botuar në dy gjuhë, Maqedonisht dhe Shqip

Për nevojat e shërbimeve administrative janë bërë parapagime të revistave: „Gazeta zyrtare e RMV”, buletini mujor i FV-konsalting, buletini mujor nga ZFR të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike të cilat mundësojnë përcjellje të vazhdueshme të ndryshimeve të dispozitave ligjore.

## **Organizimi i kohës për qëndrim në kopsht**

IPKKF gjatë këtij viti siguroi kushte optimale për punë të fëmijëve, pastaj duke preferuar specifika individualet secilit fëmijë veçmas, nevojat e tij, aftësitë, interesat etj.

Orari i punës i kopshtit ishte prej ora 6 deri në ora 18, në të gjitha objektet. Qëndrimi gjusmëditor u realizua në terminin prej ora 8 deri më ora 11, gjegjësisht 12, varësisht nga lloji i ushqimit për të cilin përcaktohen prindërit.

### **ORGANIZIMI I KOHËS** (kohëzgjatja e programeve për qëndrim) **Qëndrim gjithë ditor**

<b>Numri rend.</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Koha</b>	<b>Vërejtje</b>
1.	Pranimi i fëmijëve dhe aktivitete të lira (lojëra sipas zgjedhjes së fëmijëve)	Prej 6:00	
2.	Gjimnastika e mëngjesit		
3.	Kafjalli (mëngjesi)	8:30	
4.	Realizimi i planifikimit ditor	9:00	
5.	Rosticeri (mense)	10:00	
6.	Realizimi i planifikimit ditor	10:30	
7.	Shëtitje, vëzhgim dhe qëndrim në ajër	11:15	
8.	Rregullimi i qendrave për mësim	12:00	
9.	Drekë	12:15	
10.	Pushim pasiv – fjetje	12:45	
11.	Rosticeri (mense)	14:30	
12.	Realizimi i programeve fakultative	15:00	
13.	Realizimi i planifikimit ditor	15:30	
14.	Lojëra të lira	16:45	
15.	Rregullimi i qendrave për mësim	17:30	
16.	Shkuarja e fëmijëve	Deri më 18:00	

Viti rrjedhës 2021/2022, do të vazhdojnë masat të propozuara në protokollin dedikuar për punën e kopshtit. Në fakt secili grup i veçantë veçmas do të ketë interval të caktuar për pranim dhe përcjellje të fëmijëve. Me këtë masë do të ruhet rregulli për mos krijim të turmës gjatë pranimit të fëmijëve dhe do të pengohet përzierja e grupeve. Do të ketë kujdestari, por gjatë kësaj fëmijët nuk do të përzihen dhe secila përkëdhelëse veçmas do tua jep fëmijët prindërve.

## **2. PËRMBAJTJE E VEPRIMTARISË**

### **a) Veprimtaria e kujdesit**

Në Kopsht janë formuar 4 (katër) grupe të foshnjave të ndara në 2 objekte me gjithsej 54 fëmijë. Edukimi dhe kujdesi i fëmijëve në grupet e foshnjave realizohet nga përkëdhelëset, të cilat kanë fituar licencën për punë. Mbështetja profesionale në

planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve për të punuar me fëmijët Ju ofrojnë: Drejtori, motra medicionale dhe ekip profesional i kopshtit.

Veprimitaria bazë edukativo-arsimore realizohet në bazë të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm dhe standardeve për mësim dhe zhvillim të hershëm. Programi vjetor përbledh zgjedhje të aktiviteteve të përshtatura për moshën e fëmijëve nga 0 deri 24 muaj që janë planifikuar të realizohen në muaj, javë dhe gjatë ditës. Në këtë moshë është shumë me rëndësi bashkimi ndërmjet përkëdheljes dhe edukimit të fëmijëve të kësaj moshe. Motrat medicinale pedagogjike do të tentojnë që ta frymëzojnë dhe përkrahin zhvillimin psikofizik emocional, social, kognitiv, zhvillimin e të folurit si dhe zhvillimin psikofizik tek fëmijët.

Detyrat themelore të punës edukativo-arsimore, përkëdheljes dhe mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve nga mosha foshnjë janë:

- kujdesi dhe avancimi i shëndetit të fëmijëve (nëpërmjet të aktiviteteve për mbrojtje preventive – mbrojtje shëndetësore);
- përkëdhelje, frymëzim dhe pasurim të zhvillimit spontan të fëmijës (nëpërmjet të sistemeve të ndryshme dhe formave të aktiviteteve si dhe lojës);
- respekt të specifikositetit të punës dhe nevojat individuale e fëmijës;
- krijim të rrethit dhe strukturës së volitshme sociale-emocionale dhe strukturim të mjedisit edukativ që i përbush nevojat e fëmijëve;
- krijim të shprehive shëndetësore –higjenike;
- mirëmbajtja e higjenës.

Periudha e adaptimit është posaçërisht e rëndësishme në përshtatjen e fëmijës në mjedisin e ri dhe nga këto arsyen me kujdes të veçantë planifikohen aktivitete, të cilat fëmijës i mundësojnë qëndrim më të mirë në grup (bashkëpunim me prindërit nëpërmjet kontakteve individuale, takime me prindër, komunikim me shkrim – në bashkëpunim me ekipin profesional të institucionit).

Për pasurimin e përvjohës së fëmijëve dhe frymëzim të zhvillimit planifikohen detyra të përshtatura, përbajte dhe aktivitete të cilat do të realizohen nëpërmjet të:

- lojëra
- aktivitete motorike
- aktivitete senzo-perceptuese
- raporte sociale –emocionale
- aktivitete muzikore-ritmike
- aktivitete grafike-figurative
- aktivitete intelektuale
- aktivitete gjuhësore

Për avancimin e kualitetit të punës edukativo-arsimore dhe zbatim të Programit planifikohen aktivitete për edukim të vazhdueshëm të kuadrit të kujdesit dhe nëpërmjet të ndjekjes dhe evalvimit të realizimit të aktiviteteve programore.

### **b) Organizimi i veprimtarisë edukative – arsimore**

Veprimtarinë edukativo – arsimore në kopsht e realizojnë edukatorët me asistencë të përkëdhelësve, ndërsa në konsultim me drejtorin, edukatorin e specializuar dhe rehabilituesin, punëtorin social dhe edukatorët përgjegjës.

Kjo veprimtari në të gjitha grupet edukativo – arsimore do të planifikohet sipas Programit ekzistues për mësim dhe zhvillim të hershëm, të miratuar nga MPPS e RMV. Me qëllim që me sukses të ndiqen efektet e veprimtarisë edukativo – arsimore secili edukator mban:

- Ditarë për punë të grupit edukativ
- Ndjekje e përditshme e zhvillimit të fëmijës nga të gjitha aspektet
- Dosje të fëmijës, në të cilën parashtronen përpunime karakteristike të fëmijës, shënime anekdote, përshkrime etj.
- Analizë vjetore të temave të realizuara
- Evidencë tjetër sipas nevojës.
- Realizimi i veprimtarisë së realizuar edukativo – arsimore zhvillohet gjatë gjithë qëndrimit të fëmijëve në kopsht.

Orarin e aktiviteteve tjera të lojës gjatë ditës do ta respektojnë regjimin e përcaktuar me Programin për mësim dhe zhvillim të hershëm, por me fleksibilitet të sigurt, në pajtim me nevojat zhvillimore, individuale të secilit fëmijë dhe duke e përfshirë kreativitetin e secilit edukator, që ta pasurojë dhe ta lartësojë të planifikuarën gjithë e me qëllim të zhvillimit të qasjes gjithëpërfshirëse të zhvillimit të secilit fëmijë. Në të gjitha grupet edukativo – arsimore do të preferohet qasje individuale drejt fëmijëve, me të cilën nuk do të jenë të anashkaluar t gjitha format tjera të nevojshme të punës edukativo – arsimore.

Konform zhvillimit modern dhe të shpejtë të shkencës, teknikës dhe arritjeve të teknikës, njojurive shkencore – profesionale në edukimin dhe arsimimin, si dhe konform përvojave dhe mundësive të Kopshtit të Fëmijëve, detyra me prioritet të kuadrit edukativo -arsimor dhe atij të kujdesit në punë me fëmijët do të jenë:

- krijimi i mjedisit të volitshëm dhe pozitiv për mësim dhe zhvillim;
- Respektimi i dallimeve individuale fëmijërore, nevojat dhe sugjerimet e fëmijëve gjatë planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve edukativo- arsimore;
- Respektimi në zgjedhjen e fëmijëve dhe përdorimin e saj në mënyrë që të arrihen qëllimet specifike;

- sigruuar një mjedis stimulues, klimë pozitiv social-emocional dhe origjinalitetin në procesin arsimor;
- pasurim dhe fryshtësim të zhvillimit të fëmijës dhe avancim nëpërmjet të zhvillimit social-emocional, fizik dhe intelektual;
- ndjekje të karakteristikave zhvillimore dhe individuale;
- realizim të bashkëpunimit sa më të mirë në nivele të ndryshme: edukator-fëmijë, edukator - edukator, fëmijë-fëmijë, edukator-prindër, edukator dhe mjedisi më i gjerë e të ngjashme
- Monitorimi dhe vlerësimi i procesit edukativo- arsimor, reflektim me vetë-vlerë.

Një nga detyrat me prioritet do të jetë edhe këtë vit adaptimi dhe socializimi i tërësishëm i suksesshëm i secilit fëmijë, veçanërisht fëmijëve të cilët për herë të parë regjistrohen në Kopsht si dhe arritja e vetëbesimit dhe sigurisë te ata të njëjtit.

Veprimitari e tërësishme edukative-arsimore në Kopsht do të realizohet nëpërmjet standardeve dhe përbajtjes të "Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm "me një qasje gjithëpërfshirëse në aspektet e zhvillimit: qasjet ndaj të mësuarit, shëndetin dhe zhvillimin motorik, social dhe zhvillimit emocional, gjuhës, komunikimit dhe zhvillimin e shkrimeve, zhvillimit njohës.

### **Qasja ndaj të mësuarit**

- të zhvillojnë stilin e tyre dhe qasje në përvetësimin e njohurive dhe përvojave të reja
- inkurajim të interesit në përdorimin e formave të ndryshme dhe burimeve të informacionit;
- të zhvillojnë aftësitë për vetë-përdorim dhe motivimin e brendshme për të kryer detyrat më komplekse;
- inkurajim për zgjedhjen selektive të aktivitetet e ofruara, sipas interesave personale dhe mënyrat e të kuptuarit dhe pranimin;
- të zhvillojnë aftësinë për të filluar një aktivitet dhe këmbëngulje në realizimin dhe përfundimin e tij;
- Nxitjen e fëmijës për të shprehur kreativitetin përmes procesit të mësimit dhe zhvillimit;
- të zhvillojnë aftësinë për të përdorur njohuritë dhe përvojën e fituar në ndërtimin e një qasje personale të mësuarit;

### **Shëndeti fizik dhe zhvillimi motorik:**

- Arritje në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, me ushtrime të përshtatshme për zhvillimin e duhur;

- Zhvillimi dhe forcimin muskujve të trupit në përgjithësi;
- Menaxhimin e hapësirës dhe orientimin në hapësirë;
- Njohuri elementare të sporteve të ndryshme;
- zhvillimin motorik të imët dhe të gjerë, zhvillimin e aftësive trupore;
- Arritje dhe zhvillim i shqisave, njohuri me trupin e tij;
- Përmirësimi në funksionin e organeve shqisore në: pamje, të dëgjuarit, prekje, erës dhe llojit;
- zhvillimin e veprimtarisë ndijor dhe koordinimit ndërmjet shqisave të ndryshme;

### **Zhvillimi social-emocional:**

- zhvillim i vetëdijes për identitetin e vete fizik;
- përshtatje në mjedisin e ri, pranim të aktiviteteve të reja dhe raporte të reja;
- ballafaqim dhe kuptim të mundësive të ndryshme ndërmjet njerëzve;
- aftësi për vënien e interaksionit me moshatarët dhe të rriturit;
- zhvillim të termit për vete dhe formim të pasqyrës pozitive për vete;
- pasurim të jetës emocionale;
- frymëzim dhe zhvillim të vetëbesimit dhe mëvetësisë;
- aftësim i fëmijës që ta kontrollojë shprehjen e përvojave negative, pa i vënën në presion;
- frymëzim i emocioneve pozitive, ndjenjë e sigurisë dhe stabilitet emocional;
- zhvillim i dashurisë për njerëzit e tjera;
- zhvillim i dashurisë për atdheun.

### **Gjuha, komunikimi dhe zhvillimi i leximit**

- zhvillim i aftësive për të dëgjuar, kuptuar dhe të përjetojnë gjuhën;
  - Trajnimi për artikulimin e duhur;
  - të zhvillojnë aftësitë e komunikimit;
  - Trajnim për të dëgjuarit aktiv;
  - të zhvillojnë aftësinë për të komunikuar me gjeste jo-verbale dhe mimics;
  - nxitjen inter dhe dashurisë për librin;
  - të arrijë interes në film, radio, teatër, si dhe të kuptuarit e tyre në argëtim;
  - Arritje në tregimin e anekdota, shaka, fjalim qesharake;
  - pasurimi i fjalorit me fjalë dhe përdorimin e tyre në komunikimin e fjalës;

- të zhvillojnë aftësinë për të treguar dhe ritreguar;

### **Zhvillimi kognitiv dhe marrja e njohurive të përgjithshme**

- Përvetësimi i shfaqjeve, nocionet e objekteve dhe fenomeneve në natyrë;
- njohje me termet natyrë e gjallë dhe jo e gjallë;
- zhvillimi i kureshtjes për botën që e rrethon;
- arritje e njohurive për njeriun qenie natyrore dhe shoqërore;
- zhvillim i ndjenjës së patriotizmit;
- njoftim me komunikacionin në mjedisin e afërm;
- zhvillim të dashurisë për natyrën dhe kujdes ndaj saj;
- zhvillim të mendimit bazë logjik –matematik.

Në të gjitha grupet edukuese në të cilat janë përfshirë fëmijë prej 2 - 6 vjet realizohen format themelore të punës me fëmijë nëpërmjet të të cilave do të realizohet Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm që përfshinë

- planifikim afatgjate,
- planifikim afatmesëm tematik dhe
- – planifikimin e shkurtër ditor - planin operativ ditor.

**Për realizimin e suksesshëm të Programit, Këshilli profesional i kopshtit do të mblidhet njëherë në muaj, ndërsa në rast nevoje edhe më shumë herë gjatë vitit.**

### **LOJA SI AKTIVITET BAZË NË KOPSHT**

Loja është aktivitet i përbërë në të cilën vijnë në shprehje të gjitha proceset e funksionimit të vetëdijes njerëzore. Konkretilisht fëmijët nëpërmjet lojës shprehin kuriozitet, nevojën për bashkëpunim dhe shoqërim, arritje të kontrollit mbi ndjenjat personale, mësojnë të ndajnë gëzim, frikë, dashuri, por edhe hidhërim. Nëpërmjet lojës fëmija i shpreh aftësitë e tij krijuese, në vizatim, modelim, lojë dramatike, vallëzim popullor, këngë etj, e zhvillon vetëdije për estetikë dhe aftësi për vrojtim të së bukurës.

Programi edukativo arsimor gjegjësisht temat ditore do ti realizojmë nëpërmjet këtyre lojërave dhe aktiviteteve të lojërave:

- **Lojëra të lira** – në të cilat fëmija vetë përcaktohet dhe zgjedh me çka do të luajë,
- **Lojëra funksionale** – të cilët përbëhen në përsëritje të shpeshtë të veprimeve të cilët angazhojnë sjellje të caktuara (kapja e lëndëve me majën e gishtërinjve, lëshim, rishikim i lëndëve në ngjyra të ndryshme...)
- **Lojëra manipuluese** – me lëndë (rrotullim dhe rishikim i lëndës, trokitje etj.)
- **Lojëra simbolike** – lojëra imituese ose lojëra të prezantimit (të ushqyerit e personave tjerë, vënien e kukullës në gjumë....)
- **Lojëra dramatike** – lidhja e disa veprimeve të lojërave në përrallë të vogël (për realizimin e lojërave dramatike, është e nevojshme pajisje me kënde kukullash, teatro lëvizës kukullash, lodra mjekësore fëmije, uniforma mjekësore, çanta etj.)
- **Lojëra konstruktive** – ndërtimi i kullës me katrörë, urë, tren, modelim me pastelina, lojëra me rërë dhe ujë, lojëra me letër, tundje, ngjitje, shkyerje etj.
- **Lojëra të roleve** – fëmija han në roln e nënës, mësueses, mjekut (për realizimin e kësaj loje, është e nevojshme sigurimi i gingolëve dhe tifozëve përvendosjen e plotë të fëmijës në lojën e roleve.)
- **Lojëra didaktike** – me të cilat nxitet zhvillimi intelektual dhe socializmi i fëmijës. Ato kanë për qëllim zhvillimin e perceptimit, zhvillimin e të folurit tek fëmijët etj. Këto lojëra kanë element të mësimit dhe mund të jenë të paramenduara nga ana e vet edukatorit.
- **Lojëra tradicionale** – në të cilat fëmijët përdorin materiale natyrore.

Çdo ditë përfëmijët në Kopsht do të jetë e pranishme loja, sepse përfëmijët është e këndshme dhe një përvojë e gjuar, por njëkohësisht ajo e frymëzon dhe ndihmon zhvillimin tyre. Loja është mënyrë e mbijetesës së fëmijës në këtë botë, loja përfëmijët është përvojë përmalim dhe shfrytëzim të lëndëve nga mjeshti që i rrithon.

Hapësira ku më së shumti qëndrojnë fëmijët – salla e argëtimit, kanë ndikim të veçantë në zhvillimin kognitiv, social emocional dhe psikik të fëmijëve. Krijimi i mjeshtit të sigurt fizik dhe psikologjik, ambient stimulues që ka në dispozicion materiale të lloj-llojllojshme, detyra apo situata të përshtatura zhvillimit të fëmijës, mundëson që edukatorët të arrin mësimin nëpërmjet të hulumtimit të përbashkët dhe grupor, nëpërmjet të lojës dhe interaksionit mes fëmijëve dhe të rriturve.

**Përbajtje e planifikuara programore, detyra dhe aktivitete që do të realizohen në vitin programor, duke respektuar pikat në vijim:**

- mundësitë e të rriturve për fëmijët;
- zhvillimi individual i fëmijëve;
- dallimet individuale të fëmijëve;
- individualizimi në punë;
- sigurimi i klimës pozitive socio-emocionale;
- frymëzimi i fëmijëve drejt aktiviteteve kreative;
- respekti i zgjidhjes dhe nevojave të fëmijës;
- bashkëpunimi me familje;
- aktualitete në rrithin e jetesës;
- ndjekje dhe vlerësim i procesit edukativo-arsimor (evalvim);
- sigurimi i mjedisit stimulues, vështrim dhe autenticitet në procesin edukativo-arsimor;
- planifikimi real, përshtatja e mundësive, interesave dhe nevojave të fëmijëve, kushteve të mjedisit më të ngushtë dhe atij më të gjerë.

Edhe këtë vit programor **2021/2022** është planifikuar realizimi i temave të shumta interesante, të përshtatura për potencialet, nevojat dhe interesat e fëmijëve ku edukatori do të jetë frymëzues , organizator, kreator i qëllimeve dhe detyrave të veta.

Gjatë planifikimit do të fillohet nga Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm, bazuar në standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm ,përbajtjen dhe aktivitetet e Programit për edukimin e fëmijëve parashkollorë në institucione për përkujdesje dhe edukimin e fëmijëve, në procesin e rritjes dhe konsumimin e ushqimit të shëndetshëm, Programi "Integrimi i edukimit mjedisor në sistemin arsimor të Maqedonisë, si dhe projektet në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Puna edukativo -arsimore do të planifikohet dhe zbatohet integruar në disa nivele: në nivelin e grupeve të moshës, nivelit të objektit dhe nivelin e institucionit.

### **Temat të cilat do të realizohen me fëmijët e grupeve për vitin 2021/2022:**

"Kopshti shtëpia ime e dytë", "Vjeshta në qytetin tim", "Festojmë gëzohemi", "Unë dhe familja ime", "Zgjim pranveror", "Unë në kopsht", "Vjeshta është e pasur", "Gëzime dimërore", "Përrallat më të bukura", "Pranvera në vendin tim", "Ajde të shoqërohem", "Si të mbrohem nga viruset", "Çka na sjellë vjeshta", "I duam kafshët", "Në botën e përrallave", "Përsëri në kopsht me rregulla të reja të sjelljes", "Vjeshta e pjellore", "Festat në familjen time", "Gëzimet dimërore dhe ndryshimet e kohës", "Si sëmuremi dhe si mjekohemi", "Oborri miku im", "Ujërat e planetit Tokë", "Vera e nxeh të dhe gëzimet në verë", "Unë në kopsht", "Begatia e pranverës", "Bukuritë e pranverës", "Komunikacioni", "Vjeshta vjen", "Fustani laraman i vjeshtës",

“Familja”, “Emocionet”, “Kremtime në shtëpi dhe kopsht”, “Shkoj në kopsht”, “Bukuritë e pranverës”, “Uji”, “Vjeshta – bukuri natyrore laramane”, “Mbretëresha vjeshtore – bukuroshe dorëdhënëse”, “Bardhoshja e bardhë, si ëndër shtrati”, “Boshti familjar”, “Nuk ka planetë rezervë”, “Secili udhëtim përjetim i ri”, “Shëndeti pasuria më e madhe”, “Mjedis i pastër jetësor”, “Pa ujë nuk ka jetë”, “Aventurat verore”, “Profesionet”, “Komunikacioni dhe siguria në komunikacion”, “Unë kopshti dhe shokët e mijë”, “Vjeshta e vonë në qytetin tim”, “Gëzimet e vitit të ri”, “Ngjyrat e pranverës”

Përmes zhvillimit dhe planifikimit të temave të bazuara në përbajtjen dhe aktivitetet rrjedh dhe ndiqet zhvillimi fizik, social-emocional, intelektual dhe zhvillimin e komunikimit.

**Aktivitetet jetësore** do të janë të lidhura me jetën e përditshme të fëmijëve dhe do të kenë rol të rëndësishëm në realizimin e veprimtarisë edukative-arsimore. Nëpërmjet të këtyre aktiviteteve do të përbushen nevojat e fëmijëve të ushqimit, pushimit, qëndrimit në ajër të pastër, formimi i shprehive të punës dhe kulturo-higjenike, shprehi të punës, zhvillimi vetëdijes ekologjike etj.

### **Puna edukative**

Kopshti do të ketë për qëllim që të ndërtohet raport pozitiv drejt punës dhe shprehive të punës, të zhvillohet vetëdija te fëmija se secili njeriu ka nevojë dhe obligim të punojë, të arrijë shkathtësi dhe shprehi. Duke u nisur nga qëllimi, detyrat që do të vihen janë në vijim:

- fëmija të formojë qëndrime pozitive për punën;
- formimi i shprehive për realizimin e mëvetësishëm të aktiviteteve të caktuara; (vetëshërbim, ndihmë në punë të rriturve;
- njohje me punën e njerëzve në mjedisin lokal;
- frymëzim dhe përpunim të gjësendeve të lojërave nga materiale të llojlojshme etj.

### **Programet plotësuese**

Plotësimin e aktiviteteve të rregullta plotësuese programore në punë e përbëjnë programe plotësuese dhe periodike me kualitet më të lartë që organizohen në Kopshtin e Fëmijëve. Këto programe realizohen në kuadër të objekteve në bashkëpunim me institucione të caktuara. Për realizimin e këtyre Programeve pëlqim jepin prindërit. Me realizimin e tyre kontribuan për të inkurajuar zhvillimin e fëmijës, duke zgjeruar përvojë në segmente të caktuara të njohjes, pasurimi i aktiviteteve me përbajtje të veçantë të përshtatura sipas moshës përkatëse.

Në zgjedhjen e programeve plotësuese që organizohen në Kopsht marrin pjesë përfaqësues të komisionit për furnizime publike dhe mendimi i Këshillit të prindërve së bashku me drejtorin dhe ekipin profesional të Kopshtit.

Gjatë vitit 2021/2022 nuk do të inkudrohen programe plotësuese siç janë kursi për mësimin e gjuhës angleze dedikuar për fëmijë prej moshës 4-6 vjeçare dhe Sporti dhe lojëra sportive. Arsyja për këtë është gjendja momentale me situatën me Kovid 19 e cila sipas protokolleve të dhëna nuk parasheh dhe ndalon përzierje të grupeve. Më saktë është e ndaluar përzierja e fëmijëve nga grupe të ndryshme, që të parandalohet paraqitja ose zgjerimi i virusit. Ne përbahemi deri në atë masë dhe vepojmë në mënyrë përkatëse.

### **Programet dhe Projektet**

Në vijim të vitit 2021/2022 edhe më tutje do të punohet në realizimin e Programeve dhe Projekteve me rekomandimin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, si dhe projekteve interne.

Ekipet edukative gjatë vitit do të punojnë në Projekte interne të cilat do të realizohen në nivel të objektit. Të njëjtët do të prezantohen para prindërve dhe kolegeve nga kopshtet tjera në Republikë dhe jashtë saj.

### **Projekt për përmirësimin e shërbimeve sociale (PPSHS)**

Zgjerimin e qasjes dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve për kujdesen dhe edukimin e fëmijëve parashkollar

Bazat e programit për kohezion social dhe dialog kulturor:

- Seri trajnimesh për edukator efektiv parashkollar; (modul 1)
- Konstruktivitet, mësim i themeluar në problem, mësim i bazuar në lojë; (modul 2)

Duke e njojur rëndësinë e mësimit të hershëm, Ministria e punës dhe politikës sociale e Republikës së Maqedonisë së Veriut filloi reformë ekspansive për rritjen e qasjes dhe përmirësimin e cilësisë të arsimit parashkollar në vend. Edhe pse mësimi zhvillohet gjatë gjithë jetës, dëshmitë shkencore theksojnë se në fëmijërinë e hershme mësimi zhvillohet me shpejtësi që asnjëherë nuk do të arrihet më vonë. Katër dekada hulumtimet shkencore përcaktuan se periudha më e rëndësishme e zhvillimit të njeriut është që nga lindja e deri në vitin e tetë. Arsimin parashkollar e vendos bazën e suksesit të mëtutjeshëm në shkollë dhe në jetë në përgjithësi. Nga kjo arsyë u paraqit nevoja për implementimin e këtij programi, si kornizë e programit për mësim dhe zhvillim të hershëm, në punën parashkollore edukativo arsimore.

EDUKATORËT PËR PËRKRAHJE KOLEGIALE JU JAPIN EDUKATORËVE  
TJERË TË INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE PËRKRAHJE INDIVIFUALE NË  
KLASË NËPËRMJET AKTIVITETEVE SIÇ JANË: DEMONSTRIMI, MODELIMI,  
MËSIM EKIPOR, REALIZIM TË OPSERVACIONIT DHE SIGURIMIN E  
INFORMACIONEVE KTHYESE AUTENTIKE DHE KONSTRUKTIVE.

**Qëllimet bazë për Programin për Kohezion social dhe dialog kulturor në lidhje me edukatorët janë:**

- Të zhvillohet inteligjenca sociale dhe emocionale tek edukatorët.
- Ballafaqim më i lehtë me situata të stresit.
- Njohja e edukatorëve se çka mundet të bëjnë në lidhje me traumat tek fëmijët.
- Në çfarë mënyre ti pranojmë dhe ti kremtojmë mossukseset tona dhe të bëhem më rezistues në situata të stresit të cilët çdo ditë na i bartë profesioni ynë.
- Aktivitetet themelore të cilat na mësojnë vetëdijken dhe vetëqeverisjen.
- Njohje me neuro shkencën me qëllim që të kuptohet nevoja e strategjive për qetësim (frymëmarje, shtrëngim, përshëndetje, falënderim, rrethi i besimit, trokitje, njohje e gjetjes suaj emocionale),
- Instalimin e gjuhës pozitive në klasë (fjalë magjike: faleminderit, të lutem, më fal).
- Të motivohen edukatorët që të shprehin dashuri ndaj fëmijëve në çfarëdo situate.
- Të sigurohet personel i trajnuar mirë, vazhdimesh i përkrahur kompetent për punën me fëmijët.
- Përkrahje e aktiviteteve të cilët kontribuojnë për përforcimin e zhvillimit profesional të edukatorëve në institucionin parashkollar.
- Zbatimi i praktikave profesionale bashkëpunuese bazuar në kërkimet nga neuroshkenca pedagogjike, edukative dhe kognitive.
- Përforcimi i kompetencave të praktikuesve në sistemin e arsimit parashkollar.
- Sigurimi i mjedisit stimulues të të mësuarit në mënyrë që të sigurohen arritje më të mëdha në arsim.
-

## **Qëllimet kryesore të programit për kohezionin social dhe dialogun kulturor në lidhje me fëmijët janë:**

- Të zhvillohet inteligjencën sociale dhe emocionale tek fëmijët.
- Përmes lojës të mësohen fëmijët të përdorin gjuhë pozitive në komunikimin e përditshëm.
- Të mësojë fëmijët të shprehin pa kushte emocionet e tyre pozitive ndaj fëmijëve dhe të rriturve në situata të ndryshme të jetës.
- Të krijojë qasje holistike dhe qasje të bazuar në neuroshkencën si bazë për mësimin e hershëm dhe zhvillimin e aftësive kognitive.
- Të aftësohen fëmijët të janë më të qëndrueshëm kur dështojnë.
- Fëmijët të kenë vetëbesim më të madh dhe të zhvillojnë vetëbesim.
- Te fëmijët të zhvillohet vetëdija dhe aftësi vetëregulluese.
- Të formojë ndërgjegjësimin shoqëror dhe aftësitë për krijimin e ndërveprimit me mjedisin.
- Për të arritur mirëqenien fizike dhe mendore dhe rezistencën ndaj sfidave të ndryshme.
- Të zhvillojë aftësitë për vendimmarrje të përgjegjshme.
- Përgatitja e fëmijëve që të janë pozitivë dhe produktivë në mjedisin e tyre dhe botën në të cilën ata jetojnë.
- Fëmijët përmes lojës të kuptojnë se si funksionon truri dhe çfarë i nevojitet për të pranuar dhe praktikuar më lehtë strategji për qetësimin dhe fokusimin.
- Për të formuar të menduarit kritik.
- Të nxisë kuriozitetin dhe dëshirën për kërkime.

Projekti për përmirësimin e shërbimeve sociale filloj të realizohej në vitin 2019, dhe kopshti ynë u regjistra si projekt pilot. Ky projekt do të realizohet në gjashtë module të shpérndara gjatë gjashtë viteve të ardhshme. Së pari, me trajnim filluan disa nga edukatorët (edukatorët për mbështetjen kolegiale), të zgjedhur sipas kritereve të caktuara të përcaktuara nga MPPS, të cilët fillimi isht ndoqën trajnimin nga Dr. Rebekaa Grejçer-Ellis. Këta kolegë fillimi isht punuan mbi veten e tyre, me mbështetjen e mentorëve të tyre. Praktikuan strategji dhe teknika të provuara shkencërisht që i ndihmuan ata të arrijnë sigurinë e tyre emocionale më shpejt dhe më lehtë. Pastaj këto teknika dhe strategji (frymëmarrje, përgjime, përshtëndetje në mëngjes dhe rreth besimi) i zbatuan në klasat e tyre. Strategjitë u pranuan shkëlqyeshëm dhe u praktikuan nga fëmijët dhe efektet pozitive ishin menjëherë të dukshme. Kishte gjithashtu reagime pozitive edhe nga prindërit të cilët vetë vunë re ndryshimet pozitive në sjelljen e fëmijëve të tyre.

Pas përfundimit të trajnimit nga moduli i parë, edukatorët të cilët tashmë ishin trajnuar bënë shpërndarje te edukatorët tjérë. Edukatorët që u mbështetën nga bashkëmoshatarët e tyre për mbështetje kolegjiale e pranuan këtë projekt me interes të madh. Ata të gjithë punuan mbi veten për të miratuar teknikat dhe strategjitë dhe për të ndjerë efektin e tyre. Për një kohë të shkurtër, ata i zbatuan ato në klasa e tyre.

Edukatorët e mbështetjes kolegjiale, derisa e bënë shpërndarjen e modulit të parë, paralelisht e ndoqën modulin e dytë nën mentorimin e Dr. Rebekaa Grejçer-Ellis përmes platformës ZOOM për shkak të situatës epidemiologjike dhe protokolleve të punës. Këto takime u mbajtën një herë në javë në kohëzgjatje prej 4 orësh. Në këto takime, përveç informacionit të reja, strategjive të praktikuara, ndahen përvojat personale të edukatorëve në grupe.

Ishte kënaqësi e madhe për ne që të ishim nikoqire e takimit të kopshtit me edukatorët nga disa kopshte në Shkup, i cili u realizua sipas protokolleve të përcaktuara rreptësisht. Në këtë takim, edukatorët patën mundësinë të ndajnë përvojat e tyre nga puna në grupet e tyre arsimore, dhe përmes platformës ZOOM u lidhën me kopshtet e tjera nikoqire nga RMV. Gjatë shkëmbimit të përvojave, u ngrit një stuhi idesh për implementimin e mëtutjeshëm të realizimin të dy moduleve.

Epilogu i punës së dy moduleve të deritanishme ishte takimi i edukatorëve për mbështetje kolegjiale nga e gjithë Maqedonia personalisht me Dr. Rebekaa Grejçer-Ellis në Hotel Bellvi i cili u zhvillua sipas të gjitha protokolleve. Në këtë takim, të gjithë ishin të kënaqur me arritjet e deritanishme në punën me fëmijët dhe u bënë plane për punën e mëtejshme të edukatorëve për mbështetje kolektive.

Plani për implementimin e programit për Kohezionin social dhe dialogun kulturor për 2021/2022 është:

- Trajnim shtesë i edukatorëve nga edukatorët për mbështetjen e kolegëve.
- Mbështetje individuale e edukatorëve në klasë përmes aktiviteteve të tillë si demonstrimi, modelimi, mësimi në grup dhe këshillimi nga ana e edukatoreve për mbështetjen kolegjiale.
- Implementimi i strategjive në çdo dhomë lojërash.
- Trajnim për përkëdhelësit si pjesëmarrës aktivë në punën edukative-arsimore në secilën klasë.

*Ky projekt krijon mundësi të reja për performancë të lartë të të punësuarve në institucionin parashkollar dhe mundësi për të marrë përgjegjësi shtesë të liderëve, me atë që do të bëhen edukator dhe përkëdhelës kombëtar.*

- „Inkluzioni i fëmijëve Rom në institucionet publike parashkollore”

Projekti do të zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Fondin për Arsimin e Romëve brenda Dekadës së Romëve.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është përfshirja e 25 fëmijëve të moshave 3 deri në 6 vjeç në sistemin e edukimit të Kopshteve të integruar në grupmosha. Shoqërim mes moshatarëve, marrja e shprehive higjenike dhe punuese, shoqërimi dhe përvetësimi i njohurive dhe përvojave të reja, si dhe përgatitja për të shkuar në shkollë .

- **“Respektimi i diversitetit dhe multikulturalizmit në zhvillimin e hershëm të fëmijërisë”**

Në kuadër të programit të UNICEF-it dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup, Qendra për të Drejtat e Njeriut përgatiten materiale për realizimin e një sërë aktivitetesh që do të planifikohen në planet mujore do të zbatohet me fëmijët e moshës 5 deri në 6 vjet. Aktivitetet do të mundësojë fëmijëve që të zhvillojnë vetëbesimin dhe vetë-bindje; për të pranuar ngjashmëritë dhe dallimet mes njerëzve; për të identifikuar veprimet që ofendojnë të tjerët dhe për të kuptuar pasojat e veprimeve të tilla; të mësojnë për të reaguar në stereotipa dhe diskriminimit të drejtuara ndaj vetes apo të tjerëve.

Në 2020/2021 në nivelin e kopshtit në kuadër të Programit, projektet “Kopshti nëpër sytë e fëmijëve” “Bon ton për fëmijë”, “Nga fëmija për fëmijë”, “Riciklimi dhe imagjinata”, “Familja dhe vlerat familjare”, në mënyrë integruese do të realizohen nëpër vet programin.

Me Planet mujore do të jenë të integruar përbajtjet dhe aktivitetet për:

- Arritjen e shprehive të jetës së shëndetshme dhe sjelljet e sigurta në mesin e fëmijëve
- Përfshirja e lojërave tradicionale;

#### **Aktivitetet projektuese:**

##### **Java dedikuar fëmijës**

Këtë vit java kushtuar fëmijës për shkak të pandemisë dhe masave nga protokolli, nuk do të zhvillohet në mënyrë standarde si secilin vit. Nuk do të ketë manifestime për shënimin me të gjithë fëmijët, lojëra sportive mes grupeve, shfaqje teatrore të fëmijëve, punëtori artistike me të gjitha grupet. Java e fëmijës do të shënohet në kuadër të secilit grup veçmas, me mësueset nga grupei përkatës. Edhe përskaj kësaj do të jetë përbajtjesore dhe do ti përfshijë të gjitha aktivitetet të parapara për javën e fëmijëve.

#### **4. Në Kopsht veprojnë trupat vijuese profesionale:**

- Këshilli profesional;**
- Këshilli i edukatorëve;**
- Këshilli i përkëdhelësve.**

Trupat profesionale do të punojnë në avancimin e kualitetit të punës edukativo-arsimore, do ta ndjekin realizimin e Programit dhe realizimin e qëllimeve dhe detyrave të planifikuara, si dhe të tjera çështje profesionale.

**Këshillin profesional**- e përbëjnë drejtori, ekipi profesional i Kopshtit, udhëheqëset e objekteve. Gjatë vitit ai do të realizojë detyrat në vijim:

- Formimi i grupeve edukative arsimore;
- Planifikimi i punës edukativo-arsimore;
- Shqyrtimi dhe miratim i risive në punë;
- Zgjidhja e çështjeve që janë me rëndësi të veçantë të Kopshtit;
- Planifikimi i programit për përsosje profesionale të kuadrit edukativo-kujdesës;
- Planifikimi dhe pjesëmarrja në manifestime publike dhe kulturore.

**Këshilli i edukatorëve** - e përbëjnë ekipi profesional, drejtori i kopshtit. Gjatë vitit do të realizojnë në vijim :

- E planifikon punën edukativo-arsimore në mënyrë reale dhe në pajtim me mundësitë, nevojat dhe interesat e fëmijëve të grupit, kushtet në mjedisin më të gjerë dhe më të ngushtë.
- Përgatit plan ditor-operativ, vетор, mujor, konform bazave të Programit për mësim dhe zhvillim të hershëm,
- Mbanë evidence pedagogjike ne mënyrë elektronike dhe te shkruar
- Çdo ditë realizon aktivitete në grupin edukues duke respektuar organizmin e ditës.
- Zbaton metoda didaktike përkatëse, forma dhe principe të punës.
- I respekton dallimet fëmijërore individuale, nevojat dhe propozimet gjatë planifikimit de realizimit të veprimitarisë edukative-arsimore (në mënyrë të integruar).
- I përcjell dhe i zbaton masat dhe rregullat nga lëmi i mbrojtjes shëndetësore preventive ne Kopsht.
- Punon në adaptimin dhe socializmin e fëmijëve.
- Siguron klimë pozitive socio-emocionale, mbikëqyrje dhe autenticitet të procesit edukativo-arsimor.
- I zhvillon ndjenjat te fëmijët për estetikë, krijim, patriotizëm dhe vetëvlerësim;
- Kujdeset për vlerat njerëzore; E vërteta, Dashuria, mirësjellja, paqja dhe jodhuna dhe insiston drejt sendërtimit të tyre në karakterin e fëmijëve;
- Zhvillon vetëdije elementare ekologjike dhe raport të drejtë ndaj natyrës;

- Organizon mjedis të sigurt dhe stimulues me rregullim të hapësirës më lojëra të ndryshe didaktike, material të ndryshme, maketa, aplikime, vizatim me qëllim të fryshtimit të zhvillimit të fëmijëve duke siguar fleskbilitet të hapësirës;
- Kujdeset dhe i zhvillon shprehitë themelore kulturore – higjenike dhe ato p të punës, raport ndaj ushqimit dhe konsumimit të saj;
- E respekton zgjedhjen e fëmijëve dhe e shfrytëzon në drejtim të realizimit të qëllimeve konkrete;
- I fryshton fëmijët drejt proceseve hulumtuese, zbuluese dhe kreative si dhe drejtkonceptive të aktivizimit në planifikimin dhe realizimin e qëllimeve;
- Punon drejt ndërtimit dhe vënies së raporteve të partneritetit me fëmijët dhe prindërit,
- Planifikon dhe realizon bashkëpunim të llojlojshëm me prindërit -mbikëqyrës;
- Planifikon dhe realizon veprimitari publike dhe kulturore në grupin edukativ me fesat interesant edhe aktivitete zbavitëse.
- Bashkëpunon me përkëdhelësen e grupit, merret vesh, këmben mendime dhe jep udhëzime për format, metodat dhe procedurat e punës me fëmijë për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, për rregullim të hapësirës, për bashkëpunim me prindërit, me mjedisin lokal dhe ndërtojnë qëndrime të përbashkëta në raport me çështje në interesin e fëmijëve.
- Bashkëpunon në mënyrë intensive me edukatorët e tjera dhe ekipin profesional; institucionale profesionale dhe shkencore e të tjera në mjedisin më te gjjerë, duke respektuar principet e punës ekipore.
- Në mënyrë të rregullt dhe me kohë të duhur e udhëheq dokumentacionin pedagogjik dhe evidencën e grupit edukativ (ditar për punë të grupit edukativ në formë të shkruar dhe elektronike, planifikim dhe përgatitje të punës edukativo-arsimore, dosje për fëmijën, ditar për rregullshmëri) dhe siguron vështrim pa pengesa të së njëjtës nga ana e organeve kompetente dhe institucioneve si dhe drejtorit të Kopshtit.
- Siguron praninë e përhershme në argëtimore duke u kujdesur për sigurinë e fëmijëve .
- Bën pranimin e fëmijëve gjatë ardhjes së tyre në Kopsht.
- Merr pjesë në punën e Këshillit të edukatorëve, Aktivit të edukatorëve.
- Punon në përsosjen e vet personale shkencore, pedagogjike dhe metodike duke ndjek literaturë profesionale, literaturë për fëmijë, nëpërmjet të këmbimit të përvojave, ndjekje dhe pjesëmarrje aktive në të gjitha format e përsosjes profesionale në nivel të Kopshtit, ndjekje të seminareve dhe lloje të tjera të aktiviteteve në organizimin e institucioneve profesionale.
- Me kohë i informon shërbimet profesionale në Kopsht për qëndrimin e fëmijëve në grupin edukativ.
- Kujdeset për dukjen e tij, sjellje korakte dhe kulturore ndaj fëmijëve, prindërvë dhe të punësuarve.

- Kryen edhe punë të tjera dhe detyra tjera konform përgatitjes profesionale dhe nevojave të Kopshtit.
- Për punën e tij përgjigjet para drejtorit.  
Detyrat e tyre Këshilli i edukatorëve do ti realizoj përmes formave të ndryshme të veprimitarise: takimet e rregullta mujore, diskutime, trajnime, hulumtime dhe informacion mbi rezultatet e njëjtë etj.
- Shqyrtimi dhe miratim i raporteve, analizave ,rezultateve nga risitë e inkuadruara;
- përcjellje e punës së drejtpërdrejtë me fëmijët;
- Zbatimi metodave bashkëkohore dhe formave të punës të cilat kontribuojnë për socializim më të mirë dhe adaptim të fëmijëve në Kopsht;
- përsosje të procesit edukativo-arsimor (evalvim, vetëvlerësim, përsosje profesionale)
- Pjesëmarrje në shtyp profesional dhe tubime profesionale;
- Përpunim i literaturës profesionale dhe zhvillim profesional (pjesëmarrje në seminare, punëtori dhe këmbim të përvojave me institucione të tjera parashkollore)
- Përforcim të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunim;
- zhvillimi i shkathtësive komunikuese
- Pasurim dhe rregullim i enterierit dhe eksterierit të Kopshtit;
- Bartje të përvojës nga puna e drejtpërdrejtë me fëmijët;
- Përforcim i komunikimit me fëmijë dhe trajtim i duhur të personalitetit të fëmijës;
- Përcjellje e ligjërimit teorik nga ana e anëtarëve të ekipit profesional të Kopshtit;
- Pjesëmarrje me ide dhe propozime për planet mujore tematike sipas grupmoshave;
- Pjesëmarrje përgatitjet dhe realizimin e projekteve të planifikuara;
- Realizimi i manifestimeve, festimeve, shfaqjeve teatrale, shfaqje kukullash etj.

Detyrat e veta Këshilli i edukatorëve do t'i realizojë nëpërmjet formave të ndryshme të veprimit: takime mujore të rregullta, diskutime,punëtori profesionale, stërvitje, hulumtime dhe informim për rezultatet e të njëjtave etj.

**Këshilli i përkëdhelësve** - e përbëjnë përkëdhelëset, ekipi profesional dhe drejtori i Kopshtit. Gjatë vitit do të realizojë detyrat në vijim:

- Sipas organizimit te punës kryen pranimin e fëmijëve nga prindërit

Mban evidence pedagogjike për rregullshmëri ne forme elektronike dhe te shkruar

- Ju ndihmon fëmijëve gjatë zhveshjes, veshjes dhe mbajtjes së higjenës personale
- Nxit arritjen e pavarur dhe bën kontrollimin e zbatimit të nevojave fiziologjike të fëmijëve
- Kontrollon larjen e duarve para dhe pas ngrënies, shpëlarje e gojës dhe përdorimin e pajisjes personale dhe mjeteve për kujdese
- Siguron të qëndrojnë në ajër të pastër dhe diell çdo ditë dhe në oborr apo në tarracë në 1 orë.;
- Ju shërben ushqim dhe ju ndihmon fëmijëve të konsumojnë ushqim dhe i ofron mbështetje për nismën e tyre dhe nevojat individuale;
- E zbaton regjimin e përditshëm dhe kryen mbikëqyrje të vazhdueshme të fëmijës
- Në mënyrë aktive merr pjesë në aktivitete lojërat-edukative të organizuara nga edukatorja si bashkëpunëtor i saj.
- Bën vetë organizimin e aktiviteteve të ndryshme dhe lojërave (të planifikuara në bashkëpunim me edukatoren) gjatë kohës së pushimit-gjumit deri në kohën e përcjelljes së fëmijës;
- Siguron një gjumë të qetë –pushim ditor për fëmijët dhe gjumë qetësues (me lexim të heshtur, tregimit, muzikë ...);
- Bën mbikëqyrjen e fëmijëve gjatë gjumit;
- Nxitjen e fëmijëve në lojëra me materiale didaktike dhe pas lojës të njëjtat mblidhen , duke e vënë në vend dhe rregullon hapësirën;
- Kryen ushtrime të lehta trupore me fëmijët parandaluese – korrigjuese
- Ai siguron për qëndrim të rregullt të grumbullimit të fëmijës;
- Kujdeset që të bëhet pagesa me kohë e qëndrimit të fëmijëve në Kopsht;
- Kryen edhe punë dhe detyra të tjera në pajtim me ekipin profesional dhe nevojave të kopshtit;
- Kujdeset për hapësirën në të cilën fëmijët lëvizin dhe luajnë të jetë i përshtatshëm për çdo fëmijë
- Organizon dhe e rregullon hapësirën në të cilin fëmijët qëndrojnë dhe i njëjti të jetë miqësore, i sigurt, i rehatshëm,i stimuluar dhe i pastër;
- kujdeset për ndërrimin e rregullt të çarçafëve , përdorimin e llambave baktericid dhe ventilim të ajrit;

- kujdeset për lodrat, të mbajë higjienë e tyre me larje dhe dezinfektim;
- Merr pjesë në renditjen e hapësirës, e peizazhit të saj estetike duke bërë vizatime, piktura, pajisje sende dhe lodra;
- Bën kontrollimin e temperaturës së ajrit dhe kujdeset që të mos i ndryshohet kushtet e nxehjes;
- Bën përgatitjen e hapësirës për të fjetur fëmijët, i rregullon krevatet pas gjumit përsëri i rregullon krevatet kurse në hapësirën ku krevatet shtihen dhe mblidhen, i vendos ata në dollap të veçantë;
- Kontakton me prindërit dhe kujdestarët gjatë pranimit dhe përcjelljes së fëmijëve për të shkëmbyer informacion përfmijën;
- Në mënyrë të vazhdueshme bën përcjelljen e peshës dhe lartësinë e fëmijëve dhe me rezultatet i njofton fëmijët dhe prindërit;
- Në mënyrë aktive merr pjesë në takime prindërore në fushëveprimin e punës së tyre;
- Rregullisht informojnë prindërit në lidhje me gjendjen shëndetësore të fëmijës të shfaqjes së sëmundjeve i njoftojnë prindërit, informojnë motrën medicionale dhe edukatorin përgjegjës ;
- Merr pjesë në zbatimin e punëtorive prindërore dhe bashkëpunon me prindërit;
- Për punën e saj bashkëpunon me drejtorin , shërbime profesionale: pedagogun, punëtorin social, motrën medicionale, \_ edukatoren e grupit edukativ dhe i realizon rekomandimet të bëra nga ana e tyre;
- Kujdeset për regjin e saj , dhe sjellja kulturore korakte ndaj fëmijëve dhe prindërve, kujdestarit dhe stafit punues;
- Në mënyrë permanente, profesionale dhe aktive merr pjesë në punën e këshillit të kujdestarëve dhe formave të tjera të organizuara të zhvillimit profesional në kopshtin e fëmijëve dhe mjedisin e përgjithshëm;
- Në mënyrë aktive merr pjesë në përgatitjen e fëmijëve përfunditete edukative- arsimore, shpërndarjen e pajisje përfunduese dhe materiale didaktike;
- Kryen edhe punë dhe detyra të tjera sipas përgatitjes profesionale përfundit të kopshtit;
- Për punën e saj përgjigjet para drejtorit të kopshtit.

Të gjitha organet profesionale të kopshtit i koordinon drejtori i kopshtit.

## **5. Mbrojtja shëndetësore**

Kopshti nuk ka të punësuar si Motër medacionale kryesore dhe Mjek –pediatër dhe nga për këtë arsyе të kujdesi shëndetësor për fëmijët gjatë gjithë vitit do të realizohen në përputhje me mundësitë dhe përgjegjësitë e institucionit.

Gjatë vitit 2021/ 2022 në bashkëpunim me Drejtorinë për ushqim do të vazhdohet me zbatimin e masave të NASSR - sistemit:

- mirëmbajtje e higjenës në lokalet (kuzhinat) dhe të inventarit;
- mirëmbajtje e higjenës personale të personelit i cili është në kontakt të drejtpërdrejtë me produktet ushqimore;

### **Mbrojtja shëndetësore do të realizohet nëpërmjet të më shumë formave dhe përbajtjeve:**

- evidencë të fëmijëve të ri të pranuar,
- hapje dosjes së fëmijëve dhe evidencë të statusit vakcinal.
- Matje Antropologjike dhe kontrollime sistematike të fëmijëve si dhe kontrollime të rregullta.

Institucioni nuk ka të punësuar motër pedagogjike – medicinale dhe për këtë arsyе person tjetër në bashkëpunim me drejtorin dhe gjellëbërësin kryesor do të kyçet në Menynë për fëmijë – lista e ushqimeve. Varësisht nga mundësitë sezonale përfundimisht do të përshtatet me qëllim që të përbushen sasitë e nevojshme të materieve ushqyese në organizmin e fëmijëve. Përkrah kësaj rregullisht do të ketë mbikëqyrje rreth përgatitjes së ushqimit, përpunimit teknik, distribuimit, higjenës së enëve, higjenës së objekteve, rregullit të kontrolleve shëndetësore, kontroll në stomatolog, plantogramë për gjendjen e shputave te fëmijët si dhe rekomandim për mjekim të mëtejmë, korrigjim etj. Në program për mbrojtje shëndetësore është përfshirë edhe aktiviteti fizik si preventivë për zhvillim të drejtë të fëmijëve edhe atë:

- Në grupmoshën foshnja është i nevojshëm që të adaptohet fëmija në lëvizje të caktuara dhe ushtrime që janë të arritshme për moshën e tij;
- Për fëmijë më të mëdhenj se tri vjeç do të parashikohet gjimnastikë e mëngjesit me numër më të madh të ushtrimeve;

Nëse Gjatë vitit ka paraqitje të sëmundjeve infektuese me kohë të duhur informohet Qendra për shëndetësi publike – Shkup dhe veprohet sipas rekomandimeve të tyre.

Po ashtu për shkak të situatës së krijuar me Kovid 19, parashihen masa sipas protokollit me të cilët do të ishte vepruat në mënyrë preventive për parandalimin dhe zgjerimin e virusit Kovid 19. një pjesë e këtyre masave janë:

- Matja e përditshme e temperaturës së fëmijëve gjatë pranimit
- Ndjekja e gjendjes shëndetësore të secilit fëmijë veçmas gjatë qëndrimit në kopsht
- Konsultime të përditshme dhe këmbim të informatave me prindërit për gjendjen shëndetësore të fëmijës në kopsht dhe jashtë tij
- Të vepruarit me algoritëm të propozuar me protokoll për punë, sipas së cilit në rast të ndonjë simptome, menjëherë fëmija do të vendoset në dhomë për izolim, do të thirren prindërit dhe do të lajmërohet te Qendra për shëndet publik
- Në dobi të rruajtjes së shëndetit të fëmijëve të njëjtat masa do të ndërmerren edhe me të punësuarit nëse paraqiten simptome të dyshimta.

Nga ana e Qendrës për shëndetësi publike – Shkup bëhet kontrollim sistematik të të punësuarve dhe atë për kuzhinieret dy herë gjate vittit, kurse për të punësuarit tjerë një herë në vit.

Në mënyrë të vazhdueshme vihet bashkëpunimi me Inspektorat Sanitar Shëndetësor të Komunës së Çairit, me Entin Republikan për amvisëri në lëmi që kanë të bëjnë me kompetenca të tyre.

Gjatë vittit do të vazhdohet përsosje permanente dhe Pjesëmarrje në seminare, simpoziume, projekte, Përcjellje të literaturës profesionale që është me interes për mbrojtje shëndetësore për fëmijët.

## **6. Veprimtaria Kulturore-informative**

Gjatë vittit 2021/2022 do të realizohet veprimtari e pasur kulturore-informative nëpërmjet të Aktiviteteve të ndryshme në Kopsht dhe jashtë saj. Qëllimi i veprimtarisë kulturore-informative në Kopshtin tonë është që të kontribuohet tërësisht të realizohen detyrat e organizimit të edukatës dhe arsimit shoqëror si dhe pasurim të jetës shoqërore dhe kulturore të mjesdit.

Për realizimin e së njëjtës do të realizohet bashkëpunim me prindërit dhe me mjesdin e jashtëm në përgjithësi. Komfor programit të Kopshtit do të organizohen vizita të institucioneve me karakter publik dhe kulturor (muze, biblioteka, teatër, qendra sportive –rekreative etj.), por edhe takime me përfaqësues të tyre që do të realizohen nëpërmjet të vizitave të tyre në Kopsht. E gjithë kjo do të zhvillohet nëse imponohen kushtet për këtë, sipas protokollit dhe nëse ka pëlgim nga Ministria për punë dhe politikë sociale.

Sipas kësaj do të mundohemi që të realizojmë detyrat dhe përmbajtjet në vijim:

- afirmim më i madh i Kopshtit në mjedisin më të gjërë;
- hapje më e madhe drejt mjedisit;
- bashkëpunim më i madh me prindërit dhe familjet;
- krijim i kushteve për njohje të fëmijëve me jetën kulturore dhe jetën publike në rrithinë dhe qytet;
- krijim i kushteve që fëmijët të inkuadrohen në manifestime të ndryshme në qytet (festa, shfaqje, ekspozita arti etj.);
- Bashkëpunim me mediat lokale të shkruara dhe elektronike;

#### a. **Plani vjetor për punën kulturore - informative**

Përmbajtja	Koha e realizimit	Bartës
Shënim i Kurban Bajramit	Gusht	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Dita ndërkombëtare për mbrojtje të mbështjellësit të ozonit	Shtator	Edukatorë dhe përkëdhelës
Dita ndërkombëtare e babait	Shtator	Edukatorë dhe përkëdhelës
Dita e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë	Shtator	Edukatorë dhe përkëdhelës
Shënim i ditës botërore të maleve të pastra	Shtator	Edukatorë dhe përkëdhelës
Shënimin e Kurban Bajramit	Gusht	Edukatoret dhe përkëdhelëset, Shërbimi profesional
Shënim i Javës së fëmijëve dhe dita ndërkombëtare e fëmijës	Tetor	Drejtori, Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Dita ndërkombëtare personave të moshuar	Tetor	Edukatorë dhe përkëdhelës
Shënim i ditës botërore për mbrojtje të kafshëve	Tetor	Edukatorë dhe përkëdhelës
Shënim i ditës botërore të ushqimit	Tetor	Edukatorë dhe përkëdhelës
Shënim i ditës botërore lufta kundër varfërisë	Tetor	Edukatorë dhe përkëdhelës
Shënim i ditës së kryengritjes ë	Tetor	Edukatorë dhe përkëdhelës,

popullit maqedonas		Shërbimi profesional
Shënimi i ditës botërore të Kursimit	Tetor	Edukatorë dhe përkëdhelës,
Shënimi i ditës së Qytetit të Shkupit	Nëntor	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i Ditës së Alfabetit Shqip	Nëntor	Edukatorë dhe përkëdhelës ,
Shënimi i Ditës së Flamurit Shqiptar	Nëntor	Edukatorë dhe përkëdhelës ,
Shënimi i ditës së tolerancës	Nëntor	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës personave me nevoja të veçanta	Dhjetor	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së të drejtave të njeriut	Dhjetor	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i Ditës së mësimit në gjuhën turke	Dhjetor	Edukatorë dhe përkëdhelës,
Shënimi i Krishtlindjes – Buzmit	Janar	Edukatorë dhe përkëdhelës,
Shënimi i ditës ndërkombëtare të gruas	Mars	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës botërore të ujit	Mars	Edukatorë dhe përkëdhelës,
Shënimi i ditës botërore të teatrit	Mars	Drejtori, Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së pranverës	Mars	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së shakasë	Prill	Drejtori, Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i Ramazan Bajramit	Prill	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së shëndetit	Prill	Drejtori, Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së romëve	Prill	Drejtori, Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së planetit tokë	Prill	Drejtori, Edukatorë dhe

		përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i Pashkëve – Bazar i pashkëve	Prill	Drejtori, Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës ndërkontaktore të punës	Maj	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së Kryqit të Kuq dhe Hëna e kuqe	Maj	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së Evropës	Maj	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës botërore të muzeve	Maj	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës botërore të dallimeve kulturore, dialog dhe zhvillim	Maj	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës së arsimdashësve maqedonas	Maj	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës ndërkontaktore të fëmijës	Qershor	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional
Shënimi i ditës përmbrojtje të mjedisit jetësor	Qershor	Edukatorë dhe përkëdhelës, Shërbimi profesional

Gjatë vitiit do të mbahen edhe manifestime dhe shfaqje tjera në të cilat Kopshti i fëmijëve me dëshirë do të jetë pjesëmarrëse.

## 7. Bashkëpunimi me prindër dhe organizata të tjera

Bashkëpunimi ndërmjet institucionit parashkollor dhe familjes është me rëndësi të madhe përmes realizimin e punës edukativo-arsimore dhe nisemi nga qëndrimi se familja ka rolin kryesor në jetën e fëmijës. Që të mund fëmijët të mësojnë dhe të zhvillohen është i nevojshëm bashkëpunim më i ngushtë me ekipe edukative –arsimore, me familjet dhe të tjerët anëtarë të bashkësisë. Që të mundësohet zhvillimi te fëmijët patjetër të merren parasysh kushtet e ndryshme në familje dhe bashkësi nga e cila vijnë ata. Bashkëpunimi i suksesshëm i edukatorëve dhe familjes realizohet nëse edukatorët janë të vetëdijshëm përmes menyrat shumta nëpërmjet të të cilave familja do të kontribuonte që fëmijët të mësojnë më mirë, të përmirësohet atmosfera në sallën e argëtimit dhe Kopshtin e fëmijëve. Edukatorët i respektojnë interesat dhe përgjegjësitë e të gjithëve të cilët janë përfshirë në arsimim

dhe formimin e së ardhshmes të fëmijëve nëse realizon komunikim të suksesshëm dhe interaksion në mes familjeve, institucionit parashkollor dhe bashkësisë me çka kontribuohet për krijimin e shoqërisë më të fuqishme.

### **Format e bashkëpunimit me prindër**

#### **a) Komunikimi i drejtpërdrejtë** ndërmjet edukatorit dhe prindit

**Komunikimi me shkrim** – panel, etazh për prindërit, porosi, broshura, portfolio, vërejtje individuale dhe ngjashëm.

**Pjesëmarrje e prindërve në punën me fëmijët** – në marrëveshje me edukatorët /përkëdhelëset, ekipit profesional në Kopsht, prindi mund të inkuadrohet edhe në realizimin e disa aktiviteteve, si bashkëpunëtor i edukatorit ose të ndihmojë në periudhën e adaptimit, por edhe në organizimin e manifestimeve të ndryshme, piknikë, vizita e ngjashëm.

**Mbledhje prindërore** – me qëllim të njoftimit të prindërve me jetën dhe punën në Kopsht, tematikë, në raport me procesin edukativo-arsimor, edukimi dhe arsimimi i fëmijës.

Pas vitit të tretë organizohet dhe realizohet formë e veçantë e bashkëpunimit, e ato janë **punëtoritë me prindër**.

**Këshilli i prindërve** – Lloj i veçantë i inkuadrimit të prindërve në jetën dhe punën e Institucionit është pjesëmarrja në këtë këshill, që e përbëjnë 5 anëtarë – prindër, nga objekti „Shkurtabiqët“, dhe „Fjolla“. Dy anëtarë te Këshillit te prindërve njehërit janë edhe anëtare te Këshillit Drejtues të Kopshtit.

Me qëllim të bashkëpunimit më te suksesshëm edukatorët në mënyrë periodike do të bëjnë evalvim të të gjitha formave të bashkëpunimit me familjen.

## Plani vjetor i bashkëpunimit me familje

<b>Format e bashkëpunimit</b>	<b>Përbajtja</b>	<b>Koha e realizimit</b>	<b>Bartës</b>
Mbledhje prindërore të përgjithshme	Njoftim me kushtet e punës në Kopsh Njoftim me programin e punës	Shtator Mars	Drejtori, Shërbimi profesional Edukatorë dhe përkëdhelës
Mbledhje prindërore grupore dhe punëtori me prindër	Tema të cilat do të propozohen dhe realizohen.	Katër herë në vit	Shërbimi profesional Edukatorë
Kontakte individuale me prindër	Me iniciativë të prindërve dhe shërbimit profesional Me iniciativë të edukatorëve	Gjatë tërë vitit, sipas nevojës	Edukatorë, Drejtori, Shërbimi profesional
Anketim i prindërve	Qëllimi i anketës është njoftimi dhe përcjellja e nevojave të prindërve, sugjerimeve të tyre dhe iniciativave.	Sipas nevojës dhe vlerësimit nga shërbimi profesional	Drejtor, Shërbimi profesional i Edukatorë përgjegjës
Biblioteka për prindër	Prindërit do të kenë mundësi të shfrytëzojnë literaturë profesionale si dhe literaturë për fëmijë	Gjatë tërë vitit	Bashkëpunëtor profesional dhe Edukatorë
Këshillimore për prindër	Ndihmë profesionale e prindërve/kujdestarëve	Një herë gjatë tërë vitit	Shërbimi profesional,
„Shkolla për prindër“ dhe „Edukatë familjare“	Program Socio– edukativ për familje	Gjatë tërë vitit një herë në muaj	Shërbimi profesional
Panel për prindër	Paneli për prindër është favor dhe është me karakter informativ	Gjatë tërë vitit	Edukatorë dhe bashkëpunëtor profesional
Kuti e sugjerimeve	Në secilën sallë të argëtimit prindërit do të kenë mundësi që t'i thonë nevojat e tyre dhe pritet e tyre	Çdo ditë dhe sipas nevojës	Edukatorë
Inkuadrim i prindërve në aktivitetet e përbashkëta	Shfaqje, festime. Piknik dhe qëndrim në grupe	Gjatë tërë vitit dhe sipas nevojës	Edukatorë, Drejtori i Shërbimi profesional
Këshilli i prindërve	Aktivitete sipas planit të punës	Gjatë tërë vitit	Drejtori, përgjegjës Edukatorë i Shërbimi profesional

## **Bashkëpunimi me mjedisin e gjerë dhe me institucione profesionale**

Bashkëpunimi me mjedisin e gjerë do të realizohet sipas planit dhe në mënyrë të vazhdueshme në nivel të institucionit dhe në nivel të objektit, duke marrë parasysh specifikositetin e grupit, mjedisin dhe mundësitë për bashkëpunim. Bashkëpunimi do të jetë me karakter të hapur dhe do të tentojë ta zgjerojë drejt të gjitha institucioneve që sot kontribuojnë për avancimin e edukimit dhe arsimimit parashkollar.

Bashkëpunimi do të realizohet në më shumë relacione:

- Ministria e punës dhe politikës sociale;
  - Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe e Vetëqeverisjes Lokale;
  - Ministria e Shëndetësisë;
  - Ministria e Kulturës;
  - Komuna e Çairit
  - Byroja për Zhvillimin e Arsimit e RM;
  - Institucioni Geshtalln
  - Instituti për zë, të folur dhe dëgjim;
  - Qendra për shëndetësi publike;
  - Enti për shëndet mendor
  - Shoqata “Sina svetulka” (“Shkëndija e kaltër”)
  - Qendra “Hapni dritatet”
  - Shoqata “Montesori”
  - UNICEF
  - Fakulteti filozofik – Institut i defektologjisë, pedagogjisë, psikologjisë dhe punëve sociale
  - Qendra ndërkunuale për punë sociale e Qytetit të Shkupit
  - Drejtoria për ushqim;
  - Enti Republikan për Amvisëri;
  - Instituti për pedagogji pranë Fakultetit Filozofik në Shkup;
  - Fakulteti Pedagogjik në Shkup she Shtip;
  - SHA „Prosvetno delo“ dhe „Detska Radost“;
- Eduka mak
- Shtëpia botuese “Trimaks”

- Institucionale parashkollore në nivel të Komunës Çair, por edhe ë Nivel të Qytetit dhe Republikës, para së gjithash në plan të bashkëpunimit edukativ-profesional;
- Muze (Shkencor-natyror, M. i qytetit të Shkupit, M. i Maqedonisë, Galeria Nacionale , Muze i luftës revolucionare maqedonase dhe viktimave te komunizmit , Muze i NënëTereza etj.)
- Lidhja për kujdes dhe edukatorë përfëmijë e Qytetit të Shkupit
- Kopshti Zoologjik
- Instituti për meteorologji
- OJQ „Mir“
- Lidhja e defektologëve
- OJQ „OHO“

## **8. Veprimtaria këshillëdhënëse**

Veprimtaria këshillëdhënëse do të realizohet në bashkëpunim me organet profesionale dhe trupat këshillëdhënës pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë Arsimit dhe Shkencës dhe Vetëqeverisjes lokale, Komuna Çair, Biroja përvillim të arsimit etj.

Në vitin 2020/2021 në kopshtin do të vazhdojë me punë edhe Këshillimorja për prindër.

### **Qëllimi i Këshillimores:**

Dhënie e ndihmës profesionale dhe përkrahjes së familjeve në kultivimin dhe zhvillimin e fëmijëve, ngritje e kompetencave të prindërve / kujdestarëve për edukim dhe arsim më cilësor dhe fëmijët e tyre si dhe avancimin e cilësisë së jetës në familje. Këshillimorja është e hapur përfshirë në procesin edukativo – arsimor të kopshtit si dhe të fëmijëve të cilët janë përfshirë në shërbimin edukativ – arsimor të kopshtit si dhe të fëmijëve të cilët nuk e vizitojnë kopshtin.

### **Pse këshillimore për prindër / kujdestarë?**

Prindërit/ kujdestarët gjithnjë e ml shpesh kanë nevojë të përkrahjes plotësuese në lidhje me zhvillimin, edukimin, arsimimin, ushqimin, kurën dhe shëndetin e fëmijëve të tyre.

Jo përherë janë në gjendje në mënyrë të pavarur ti edukojnë ose nuk kanë shprehi në situata kur u është e nevojshme vetëm këshillë, e jo ndonjë lloj trajtimi të paraqiten në institucionet shëndetësore ose nga sfera e mbrojtjes sociale dhe të kërkoijnë ndihmë.

Institucionet parashkollore janë vende ku për shumë pyetje të këtilla munden të marrin përgjigje, të informohen se ku të drejtohen për ndihmë, të arrin njoħuri dhe aftësi të caktuara të cilët do tu ndihmojnë për prindër të shëndoshë dhe fëmijëri të lumtur të fëmijëve të tyre.

### **Çka paraqet këshillimorja për prindërit / kujdestarët?**

Këshillimorja për prindër realizohet si Program i veçantë i përputhur me principet e ardhjes vullnetare për këshillim, kapshmëri për të gjithë prindërit e interesuar e fëmijëve nga mosha parashkollore në nivel të Komunës, diskrecion në punën.

Funksioni bazë i programit është informativ, preventiv, edukativ dhe këshillëdhënës.

#### **Format e punës:**

- biseda individuale me prindërit / kujdestarët
- punë në grupe më të vogla dhe më të mëdha
- ligjérata, tribuna dhe punëtori

#### **Përbajtjet dhe aktivitetet:**

- » Biseda individuale me prindërit/ kujdestarët zhvillohen çdo ditë me caktim paraprak në telefon tek ekipi i këshillimores.
- » takime edukative dhe tematike me prindërit/kujdestarët (puna në grupe më të vogla dhe më të mëdha, ligjérata, tribuna, punëtori),
- » ligjérata edukative/profesionale për edukatorët, përkëdhelëset dhe motrat medicinale,
- » konsultime lidhur me situata specifike jetësore fëmijë/familje,
- » informim për të gjitha karakteristikat e rritjes dhe zhvillimit tek fëmijët e moshës parashkollore
- » si ta përgatisin fëmijën për të shkuar në kopsht dhe shkollë,
- » arritja e njohurive për lojën dhe mënyrën e stimulimit për lojë,
- » zgjedhja e librave për fëmijë dhe zhvillimin e tyre,
- » arritja e njohurive për mënyrat e nxitjes dhe zhvillimit të interesave të fëmijëve, aftësitë dhe nevojat
- » zhvillimi i aftësive të edukimit të fëmijëve në familje,

» kërkimi i zgjidhjeve të përbashkëta për problemet aktuale, dilema dhe vështirësi me të cilat ndeshen prindërit në përkujdesen e fëmijëve.

### **Ekipin e Këshillimores e përbëjnë:**

Natasha Stojkovska – edukator special dhe rehabilitues

Ilaz Koka – punëtor social

Veprimtaria këshillëdhënëse do të organizohet në kompetencë të drejtorit, shërbimeve profesionalet Kopsht në bashkëpunim edukator-prindërit dhe bashkëpunëtorë të jashtëm – individ dhe institucione.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet fëmijëve me nevoja të veçanta nga ana e shërbimit profesional të kopshtit në bashkëpunim me kuadrin edukativ kujdesur dhe defektologë, logopedë nga Enti për të folur dhe dëgjim.

## **VEPRIMTARIA SOCIALE**

Kujdes të veçantë do ti kushtohet në zhvillimin e ndjenjave pozitive te fëmijët gjatë realizimit të aktiviteteve të punës, do të shfrytëzohen faktorët social dhe kontaktet ekzistuese me persona të tjerë për zgjerimin e përvojave te fëmijët, e cila do t'i shërbejë për socializëm të mëtejmë në jetë.

Edukatori rregullisht komunikon me prindërit dhe familjen e fëmijës dhe i nxitë të inkuadrohen në procesin edukativo-arsimor (respektohet personaliteti i prindërit, të ofrojnë mënyra në të cilat prindërit do të inkuadrohen, ju jep kurajë prindërve për zhvillim të bashkëpunimit, ruan informacion të besueshëm të familjes).

Në këtë mënyrë edukatori ndan përgjegjësi, në procesin e ndarjes së vendimit për edukim dhe arsimim të fëmijës, po ashtu në këtë mënyrë vet ekipi arrin siguri në kompetencat e tij profesionale.

Për socializim të suksesshëm dhe proces edukativo-arsimor të suksesshëm është shumë e rëndësishme të ketë bashkëpunim të mirë në ekip. Ata duhet që së bashku të marrin pjesë në planifikimin dhe realizimin e qëllimeve të caktuara në punën e edukativo-arsimore. Në këtë mënyrë hapet atmosferë punë shumë e mirë dhe mirëbesim i ndërsjellë dhe siguri që është një bazë e mirë për zhvillim dhe ndërtim të punës ekipore.

Puna ekipore paraqet ndarje të roleve dhe definim të vizionit të përbashkët si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve individuale dhe avancim të procesit edukativo-arsimor. Ajo që është karakteristike për punën ekipore pa marrë parasysh ndarjen e roleve dhe përgjegjësive, anëtarët e ekipit ndihmojnë njëri-tjetrin de japid sugjerime për secilin segment të procesit të punës.

Po ashtu komponentë shumë e rëndësishme për procesin e tërësishëm edukativo-arsimor duke shikuar nga aspekti social është dhe bashkëpunimi me bashkësinë lokale ku bëjnë pjesë bibliotekat, kopshtet e tjera, shtëpitë

shëndetësore, qendra për punë sociale, muzetë etj, me të cilat do të realizojmë kontakte Gjatë vitit. Në këtë mënyrë i mësojmë fëmijët si të krijojnë lidhje me të tjerat dhe si të bëhen anëtarë të rupeve të ndryshme, si të ndihmojë të tjerët dhe s' të pranojë ndihmë nga të tjerët.

## **8. Zhvillimi profesional**

Praktikën kualitative pedagogjike e implementojnë edukatorët të cilët në mënyrë permanente japid kontribut në zhvillimin e tyre profesional, që i shfrytëzonin dituritë e tyre në praktikën e përditshme dhe që bashkëpunojnë me të tjerët në krijimin e mësimit të përfjetshëm. Edukatorët do të modelojnë dhe ndajnë kënaqësinë nga mësimi duke dhënë mundësi për zhvillimin e tij dhe përmirësimin, si dhe është i përgatitur që t'i përgjigjet sfidave në jetën dhe punën e përditshme, ndryshimet shoqërore, numrin e madh të informacioneve dhe paraqites së teknologjive të reja. Pjesëmarrja aktive, mendimi kritik dhe puna e partnershipit dhe të tjerëve i mundëson edukatorit që të përfitojnë dituri dhe shkakhtësi të reja, t'i formojë qëndrimet, ta pasurojë personalitetin e tij dhe të bëhet më i vendosur për arsimin kualitativ për të gjithë fëmijët.

Zhvillimi profesional i të punësuarve të Kopshtit të Fëmijëve do të realizohet me:

- Pjesëmarrje në konferanca ndërkombëtare;
- Pjesëmarrje në seminare dhe punëtori;
- Pjesëmarrje në punëtori të organzuara ndërmjet institucioneve parashkollore në Shkup dhe ne nivel të Republikës së Maqedonisë
- Përcjellje e literaturës profesionale

Gjithsesi e gjithë kjo në kushte përkatëse të cilat i imponon situata me pandeminë me Kovid 19 duke i respektuar protokollet për atë.

### **Plani vjetor për zhvillim profesional dhe përkryerje profesionale**

Tema e përkryerjes profesionale	Realizuesit	Pjesëmarrësit	Koha e realizimit
Nxitjen e motorikes tek fëmijët deri në 2 vjet	Edukatori special	Përkëdhelëset nga grupet e çerdheve	Tetor
Pasojat nga zhvillimi jo i drejtë motorik tek fëmijët e moshës parashkollore	Edukatori special	Prindërit	Nëntor
Përfitimet nga zhvillimi i drejtë motorik tek fëmijët e moshës parashkollore	Edukatori special	Edukatorët dhe përkëdhelëset nga grupei prej 3-6 vjet	Dhjetor
Njohja e fëmijëve me spektrin autiatik të sjelljes dhe nevojat e tyre	Edukatori special	Edukatorë, përkëdhelëse	Shkurt
Njohja e fëmijëve me spektrin autiatik të sjelljes dhe nevojat e tyre”	Edukatori special	Edukatorë, përkëdhelëse	Mars

## **9. LLOJI I VEPRIMTARISË**

Kopshti sipas kohëzgjatjes do të realizojë programe për:

- qëndrim tërëditor;
- qëndrim gjysmëditor;

Programet për qëndrim tërëditor zgjasin prej 9 deri 11 orë, programet për qëndrim gjysmëditor zgjasin 4 do 6 orë. Këto programe dhe programet janë dedikuar për fëmijët e moshës derri në nismë për në shkollë fillore dhe përfshijnë kujdes dhe edukim për fëmijë.

Gjatë periudhës verore pamvarsisht prej nevojave të prindërve janë kujdesur edhe fëmijët e moshës madhore deri 9 vjet. Kushtet e vendosjes ishin të njëjtë edhe për fëmijët të moshës 6 vjeçare.

Gjatë ditës fëmijët janë angazhuar me Aktivitete nga më shumë lëmi: Aktivitete fizike, muzikore, arti figurativ, lojëra të tjera të ndryshme shoqërore dhe të tjera aktivitete që do të burojnë nga interes i fëmijëve.

## **10. SHPENZIMET MATERIALE**

Veprimtaria e Kopshtit të fëmijëve sigurohet nëpërmjet të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore. Për sigurimin e kushteve për qëndrim të rregullt të fëmijë në Kopshtin e fëmijëve dhe standard jetësor që i përgjigjet zhvillimit fizik, mental, emocional, moral dhe social të fëmijës, për përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit dhe zhvillimit psikofizik të fëmijës është patjetër të sigurohen mjete. Në bazë të burimeve të caktuara të financimit dhe shpenzimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarisë me fëmijë sipas normave dhe standardeve konform programit për punë edukativo-arsimore, Gjatë vitit në vijim nevojat përfurnizim janë planifikuar dhe caktuar sipas llojeve të ndara të shpenzimeve, furnizime që janë të patjetërsueshme për realizimin e veprimtarisë. Për këtë dedikim përgatisim Plan vjetor finanziar si dhe Plan vjetor përfurnizime publike. Konform ligjeve për Mbrojtje fëmijërore shpenzimet për realizim normal të veprimtarisë sigurohen fillimisht nga mjetet e shfrytëzuesve të shërbimeve – prindërve dhe nga buxheti i komunës – mjete nga dotacionet me dedikim.

Mjetet e Siguruara në bazë të këtyre elementeve shfrytëzohen me dedikime, racionalist dhe në mënyrë ekonomike konform Ligjit për realizimin Buxhetit si dhe të tjera akte normative, si dhe në bazë të planeve kuartale financiare mujore në bazë të Planit vjetor finanziar që dorëzohen dhe miratohen nga ana e Komunës Çair.

Për vijim pa pengesa të veprimtarisë është e domosdoshme për disa nevoja shpenzimesh të cilat do të realizoheshin me procedura përfurnizime publike edhe të për: ushqim, mjete për higjenë, mjete për sigurim të objekteve, servisim të

pajisjeve, furnizim me pajisje, kontrollime shëndetësore të të punësuarve, mirëmbajtje vijuese dhe investuese të objekteve, furnizim me çarçafë të shtretërve, furnizim me lojëra, mjete audiovizuale dhe mbikëqyrëse për realizimin e programit për punë me fëmijë etj. Shpenzimet e tjera të domosdoshme për funksionim normal të institucionit janë: shpenzime për rrymë, ujë, ngrohje qendrore, shërbime telefonike etj.

Kontrolli i dinamikës së realizimit të mjeteve financiare realizohet me dorëzim të raporteve periodike dhe kumulative financiare M1 dhe M2 si dhe raporte kuartale financiare për realizimin e të hyrave dhe të të dalave për të llogaritë (llogari të të hyrave vetanake si dhe llogaria për dotacione me dedikim) deri te Sektori për financa dhe buxhet pranë Komunës së Çairit.

#### **4. MJETET BAZË DHE PAJISJET**

Institucioni publik nuk ka në dispozicion mjete bazë dhe pajisje. Kemi në dispozicion relativisht makina përkatëse për kuzhinë. Në kohën e gjithë më të madhe për të kryer punën profesionale me kohe dhe të përparojmë ne teknologjinë informative dhe përcjellja e trendëve moderne ne punën edukativë pedagogjike. Kopshti ka ne dispozicion mjetet IKT dhe atë vetëm ne objektin ame, por mendojmë se jetojmë në kohën kur informatika shkon përpara dhe për ketë shtohet nevoja për pajisje të mëtutjeshme në objektet me mjete kompjuterike. Është e nevojshme që të gjitha objektet të pajisen kabinetet për kuadrin arsimor me kompjuterë me qëllim e përsosjes profesionale dhe të avancimit në teknologjinë informatike dhe përcjellje të trendëve moderne në punën edukative pedagogjike.

Po ashtu zyrtat dhe një pjesë e sallave për argëtim janë klimatizuar, mirëpo mendojmë se edhe më tej duhet të investojmë mjete për aklimatizim me qëllim që t'i sigurojmë fëmijëve qëndrim të këndshëm gjatë ditëve të nxehtha verore kur temperaturat janë shume te larta.

Mobilitet në argetimore janë vjetësuar dhe pre atë qellim ekziston nevoja e madhe për porositjen e saj me qellnim që fëmijët gjate qëndrimit të kenë mobile me kualitative dhe te re.

#### **5. MIRËMBAJTJA VIJUESE DHE INVESTUESE**

Tendenca jonë që të sigurojmë mijdis të shëndoshë dhe të shëndetshëm përfëmijët si dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në nivel sa më të lartë. Në këtë drejtim kemi n plan renovimin dhe modernizimin e objekteve.

Gjatë vitit 2020/2021 Kopshti do të tentojë që të sigurojë mjete financiare të drejtuara kah modernizimi dhe avancimi i qëndrimit të fëmijëve.

Për këtë qëllim Kopshti gjatë vitit 2020/2021 do të tentojë që t'i ndërmerr këto aktivitete:

- Rekonstruktimi i oborrit nga njëra hyrje te tjetra në objektin „Shkurtabiqët“
- Rinimi dhe plotësimi i inventarit në dhomat e lojës dhe kopshtin
- Rinimi dhe pasurimi i rekuizitave në salla të dedikuara për aktivitete sportive;
- Rinimi i një pjese të sipërfaqeve të oborreve të të dyja objekteve të kopshtit;
- Mbjellja e bimëve kaçubore dhe druve gjethembajtës dhe gjetherënës;
- Pajisim i kuzhinës konform HACCP standardeve;
- Sigurim të aparateve klimatike për secilën klasë
- Pajisja e klasave me mjete audio – vizuale dhe laptopë
- Shtruarja e laminatit në klasat ku ka nevojë

Në vazhdimësi do të vazhdojmë me mirëmbajtjen e rekuizitave dhe pajisjen me të reja, ndërsa në bashkëpunim me komunën vendosjen e ndriçimit me qëllim të mbrojtjes më të madhe të objekteve, si dhe mundësi për shfrytëzim në orët e natës të oborreve të objekteve; do të vazhdojmë me mirëmbajtjen e oborreve.

- furnizim me rekuizita për çerdhe në objektin Fjolla
- zëvendësim i dyshekëve për krevate në disa prej objekteve
- Sajimin e këndeve sanitare për fëmijë dhe të punësuar
- Ngjyrosja me llaç e parketit
- Investim në drejtim të ndërrimit të mobileve dhe dollapëve në klasa dhe korridore
- Ndërrimin e ndriçimit në të gjitha objektet me led ndriçim kursyes,
- Mbjellja e bimëve shkurre
- Furnizim me elemente për qendra të ndryshme dhe materiale konstruktive (prej druri dhe plastike)
- Furnizim i literaturës për fëmijë për pasurinë e qendrës letrare
- Furnizim i rekuizitave për aktivitete sportive për sallat në të gjitha objektet
- Pajisja didaktike e klasave
- Është paraparë furnizim i titujve të rinj letrar, doracakëve, ilustrime, tregimeve dhe teksteve dramatike, ndërsa sipas nevojës edhe enciklopedi e llojeve të ndryshme për fëmijët, libra me lojëra për fëmijë etj.

Një pjesë e këtyre aktivitetave u planifikuan në vitin e kaluar 2020/21, një pjesë përfunduan, ndërsa pjesa tjeter me të rejat, planifikohet të realizohen në vitin në vijim 2021/22.

*Në të gjitha objektet në kontinuitet do të bëhet pajisja me pjesë të reja të mobileve, krevateve, karrigeve, shtretërve, tavolinave, roletave veneciane dhe variolat, tepisonave e veçanërisht do të pasurohen kopshtet me lojëra dhe ,materiale të reja didaktike.*

## PROGRAMI

### **PËR PUNË I DREJTORIT TË INSTITUCIONIT PUBLIK KOMUNAL KOPSHTI PËR FËMIJË “SNEZHANA” PËR VITIN 2020/2021**

Drejtori si organ udhëheqës i IPKKF, me punën e tij do të udhëheq në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe akteve statutare të IPKKF, ndërsa në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Komunën e Çairit, Ministrinë e punës dhe politikës sociale, si dhe me institucionet tjera profesionale, asociacione edukative arsimore, persona profesional të cilët pas shfaqjes së nevojës do të konsultohen. Drejtori gjatë viti programor 2020/2021 aktivitetet e tij në institucion do t`i drejtojë në pajtim me qëllimet e tij strategjike të krijuara për zhvillim të institucionit dhe në bazë të vlerësimeve aktuale të nevojave të kopshtit, fëmijëve, prindërve, të punësuarve, mjedisin lokal etj.

Një pjesë e detyrave të drejtorit të cilat do të janë preokupim kryesor këtë vit janë:

- Forcimin e ndjenjës së sigurisë dhe stabilitetit të të punësuarve në punë dhe të detyrave të punës;
- Krijimi i perspektivës te te punësuarve për realizim të qëllimit të shtruar;
- Frymëzimi i të punësuarve për punë ekipore;
- Krijimi i klimës pozitive në kolektiv,

Në punën e tij Drejtori do të jetë koordinatori kryesor dhe organizatori i punë në përgjithësi në kopsht. Aktivitetet e tij në programin 2019/2020 do të drejtohen drejt përfundimit të vendosjes së qëllimeve dhe objektivave:

- E organizon dhe e udhëheq punën e Institucionit publik;
- Në vazhdimësi e ndjek dhe e koordinon punën e institucionit në tërësi, realizimi i vendimeve të Këshillit drejtues, Këshillin e prindërve, bashkëpunimi me organet dhe trupat e vetëqeverisjes lokale dhe MPPS,
- Përpilimi i Programit vjetor për vitin 2019/2020 dhe Raporti i punës së kopshtit për vitin 2018/2019
- Implementimi i rregulloreve të reja për punë në institucion, në pajtim me ndryshimet e ligjit për mbrojtjen e fëmijëve,
- E përfaqëson Institucionin publik para organeve kompetente dhe personave të tretë dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës në kopshtin e fëmijëve;

- Merre pjesë dhe përgatit programe dhe plane për punë jashtë institucionale të fëmijëve;
- Dorëzon raport për realizimin e programit vjetor për punë te personat profesional dhe te institucionet kompetente: Këshilli drejtues i Kopshtit të fëmijëve, Komuna (themeluesi) dhe Ministria e Punës dhe e Politikës sociale;
- Dorëzon raport për punën materiale financiare të Kopshtit të fëmijëve te institucionet kompetente: Këshilli drejtues i Kopshtit të fëmijëve, Komuna (themeluesi) dhe Ministria e Punës dhe e Politikës sociale;
- E udhëheq, organizon dhe kontrollon punën administrative – financiare të Kopshtit të fëmijëve;
- Përgatit plan për furnizime publike;
- Planifikon, krijon dhe udhëheq politikë afariste për zhvillim dhe avancim të veprimtarisë në Kopshtin e fëmijëve;
- Kujdeset për mirëmbajtje investuese-vijuese të objekteve;
- Drejtori do të përpiqet për përmirësimin e kushteve të përgjithshme për punë, gjetje e hapësirës për pranimin e numrit sa më të madh të fëmijëve, të cilët për momentin janë në listën e pristes, me këtë edhe hapjen e grupeve të reja edukative, punësime të reja dhe përmirësimin e standardeve të fëmijëve dhe të tē punësuarve në Institucion dhe gjetjen e sponsorëve dhe donacioneve, të cilët do të kenë për qëllim që ta përmirësojnë jetën e fëmijëve në Institucionin,
- Kujdeset për funksionim normal të pajisjeve, mobileve, aparateve,makinave dhe të tjera mjete që shfrytëzohen në punë e përditshme të nëpunësve publik;
- Kujdeset për realizimin e rregullt të punëve dhe të detyrave të punës nga ana e nëpunësve publik;
- Lidh kontrata në kuadër të autorizimeve të tij të caktuara me Ligj dhe Statut;
- Miraton aktvendime për shfrytëzimin e pushimeve verore, mungesë të paguar apo të papaguar të nëpunësve publik;
- Vendos për pranim të nëpunësve publik në bazë të rang-listës së propozuar nga komisioni për seleksionim, ndërsa me pajtim të mëhershëm për mjete financiare të siguruara nga organi kompetent;
- Merr pjesë aktive në punën e Këshillit të prindërve në Këshillin e prindërve të Kopshtit të fëmijëve;
- Bën orarin e nëpunësve publik;
- E përcjell zbatimin e aktiviteteve nga lëmi i mbrojtjes preventive shëndetësore në Kopshtin e fëmijëve;

- Bën punën pedagogjike-instruktive dhe mbikëqyrje te punës edukative-kujdesore të edukatorëve dhe përkëdhelësve dhe të nëpunësve e bashkëpunëtorëve;
- Punën me organet profesionale do ta realizojë në mënyrë permanente me planifikim dhe programim të punës së: Këshillit profesional, Këshillit të edukatorëve dhe Këshillit të përkëdhelësve,
- Bën vështrimin e evidencës pedagogjike dhe të dokumentacionit që udhëhiqet në Kopshtin e fëmijëve;
- Realizon bashkëpunim me prindërit konform akteve ligjore dhe Programit Kopshtit;
- Pranimin e propozimeve, sponsoreve dhe donacioneve nga prindërit – përmirësimin e cilësisë së komunikimit edukator – prind, përkëdhelës – prind, i punësuar – fëmijë, gjithë e me qëllim krijimin e besimit dhe sigurisë së ndërsjellë,
- Në mënyrë permanente punon drejt përsosjes profesionale dhe shkencore;
- Zbaton masa dhe aktivitete për realizmin e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve;
- Organizon aktivitete në drejtim të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe formimin e shërbimit profesional (pedagog, punëtor social dhe koordinator edukativo-arsimor) në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e vetëqeverisjes lokale;
- Merr pjesë në përgatitjen dhe udhëheqjen e seancave të Këshillit profesional;
- Përgatit propozim – detyrime për anëtarët e ekipit profesional të kopshtit për përpunimin e pjesëve të veçanta – nga lëmi i Programit vjetor;
- Përcjellje, analizë dhe vlerësim të aktiviteteve programore;
- Përgatitje të analizave, kritika, raporte, informacione dhe të tjera materiale profesionale në lidhje me realizimin e Programit vjetor për punë të institucionit dhe me kërkesë të Ministrisë përkatëse, Komunës dhe të tjera institucione;
- Merr pjesë në formimin e grupeve edukative sipas moshës së fëmijëve;
- Përcjellje, analizë dhe përgatitje të tabelave dhe pasqyrave për numrin e të regjistruarve, fëmijëve të pranishëm dhe të çregjistruar.
- Analiza plotësuese dhen hulumtime në lidhej me gjendjen e pranisë së fëmijëve në nivel të grupit edukues dhe në nivel të kopshtit në tërësi;
- Pjesëmarrje në planifikimin e ushqimit për fëmijë dhe njëherë në kryerjen e analizave mujore për shpenzimet e së njëjtës;
- Pjesëmarrje në ekipin mjekësor në përgatitje të listës për ushqim të fëmijëve të foshnjores dhe moshës së tillë, me qëllim që e njëjta t'i përmbush normat

dhe standartet e parapara të ushqimit të fëmijëve të moshës parashkollar në bashkëpunim me Entin republikan për amvisëri dhe Institutin për shëndet publik të RM, si dhe udhëheqje të kujdesit për mbrojtjen e tërësishme shëndetësore dhe preventivë;

- Vështrim në punën administrative financiare, materiale dhe administrative;
- Pjesëmarrje në përgatitjen e planeve vjetore, kuartale dhe planet mujore financiare për realizimin e mjeteve të planifikuara;
- Aktivitete të drejtuara kah implementimi i plotë i standardeve HACCP;
- Pjesëmarrje në punën e Këshillit drejtues, informim për gjendjen dhe punën në tërësi të IKPKF dhe realizim të konkluzioneve dhe vendimeve të miratuara;
- Bën ekspertizë, përcjellje dhe drejtim të punës së përkëdhelësve, edukatorëve dhe punëtorëve profesional dhe bashkëpunëtorëve;
- Përcjellje dhe përballje me kohë nga nevoja e ndryshimeve eventuale të kuadrit me qëllim të realizimit me kohë të punës dhe arritjeve të rezultateve të mira;
- Mundohet për disiplinë dhe përgjegjësi të të punësuarve për punë më të suksesshme gjatë realizimit të detyrave dhe njëherë për sukses në punë racionale;
- Planifikon, programon dhe koordinon forma të ndryshme të përsosje së vet profesionale dhe të kuadrit edukativo kujdesor;
- Organizon pjesëmarrje të takimeve profesionale, seminare, këshillime, simpoziume në bashkëpunim me organet kompetente dhe institucionet e shtetit, veçanërisht me MPPS, MASH konferenca ndërkombëtare e tjera;
- Bën punë të tjera të parashikuara me Ligj, Statut dhe Akte të IKPKF.

Drejtori i kopshtit do të tentojë që qëllimi kryesor të jetë sigurimi i kushteve normale fizike, intelektuale, emocionale dhe zhvillimi social i fëmijëve të moshës 8 muajsh deri 6 vjeçare:

- Të sigurojë kushte për funksionimin e sistemit të vetëm të punës edukative-arsimore, kujdesit, ushqimit,mbrojtjes shëndetësore dhe sociale;
- Në bashkëpunim me familjen, mjedisin më të gjerë lokal të sigurojë unitet në ndikimin edukativ të fëmijës dhe jetës me kualitative më të pasur në kopsht;
- Do të bëjë vizita grupeve edukative në të gjitha llojet e aktiviteteve, do ta ndjek, koordinojë, orientojë, kujdes, veprimtari edukativ arsimore nga ana e përkëdhelësve, edukatorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe të punësuarve tjerë në kopshtin.

- Do të realizojë biseda, konsultime, këshillime të obligueshme me punëtorët me qëllim që të përmirësohen mospërputhjet e konstatuara dhe të përmirësoset veprimitaria.
- Në këtë drejtim të sigurojë edukim të kuadrit profesional;
- Të gjejë mundësi për pajisje kualitative të hapësirë së mbyllur dhe asaj të hapur ku qëndrojnë, jetojnë, punojnë dhe mësojnë fëmijët
- Të Kujdeset për kushtet e punës së të punësuarve si dhe për situatën e tyre materiale;
- Që në kuadër të mundësive të organizojë forma alternative të punës ne fëmijë dhe më të moshuar (punëtori, gjuhë të huaja, lojëra, punë gjatë fundjavës, galeri për fëmijë, rekreacion e ngjashëm.) ;
- Realizon edhe të tjera shërbime në qarkun e punës së Institucionit të parapara me Statut.

## PROGRAMI

### **PËR PUNËN E EDUKATORIT SPECIAL DHE REHABILITUSET TË INSTITUCIONIT PUBLIK KOMUNAL KOPSHTI PËR FËMIJË “SNEZHANA” PËR VITIN 2021/2022**

**Edukatori special dhe rehabilituesi** si punëtor profesional duke i përmbushur nevojat e fëmijëve dhe prindërve, detyrat e tija të punës do ti realizojë në dy objekte dhe atë:

E hënë dhe të martën në objektin “Shkurtabiqët”, mërkurë dhe e enjte në objektin “Fjolla”, ndërsa të premten sipas nevojave të punës.

#### **Qëllimi i punës**

Edukatori special dhe rehabilituesi si person profesional në Kopsht ka për qëllim: preventivën, identifikimin, korrigjimin dhe kompensimin e pengesave specifike në zhvillimin psikomotorik, senzorik, kognitiv, social, emocional dhe të folur-gjuhësor të fëmijëve. Nëse lejojnë Protokollet për shkak të situatës me Kovid 19 punën e tij do ta realizojë nëpërmjet punës grupore dhe individuale me fëmijët. Nëse nuk ka mundësi të këtillë puna më së shumti do të jetë këshillëdhënëse me qëllim gjithnjë e më mirë adaptim dhe qëndrim të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kopsht. Në mënyrë të vazhdueshme do të bashkëpunojë me prindërit, edukatorët, përkëdhelëset dhe punëtorë dhe bashkëpunëtorët tjerë profesional në kopsht dhe jashtë tij. Me punën e tij profesionale duhet të kontribuojë në përmirësimin e punës edukativo - arsimore me fëmijë me aftësi të kufizuara në institucion në bazë të qëllimeve, principeve dhe standardeve të edukimit dhe arsimit.

### **Detyra të veçanta:**

- Nxitja e vetëdijes për fëmijët me zhvillim jo tipik, pranimi i tyre si pjesë nga mjetet dhe krijimin e kushteve optimale për funksionimin e tyre në kopsht dhe mjedisin më të gjerë në mënyrë të mbledhjeve, punëtorive dhe bisedave individuale me prindërit/kujdestarët dhe kuadrin edukativo- përkujdesës.
- Ndjekja e fëmijëve me faktorë rreziku në zhvillimin dhe ndërmarrje të masave për preventivë dhe nxitjen e zhvillimit motorik, senzorik, kognitiv, special, emocional dhe të së folurit.
- Informim i vazhdueshëm i prindërve / kujdestarëve për prezencën e zbulimeve të çrregullimeve të zhvillimit tek fëmijët.

### **PLANI AKCIONAL I EDUKATORIT SPECIAL DHE REHABILITUSET**

Përbajtja e punës	Detyrat	Koha e realizimit
<p><b>Detyrat dhe aktivitetet në lidhje me fëmijët</b></p> <p>Qëllimi: preventiva, zbulimi i hershëm dhe korrigjim të çrregullimeve zhvillimore</p>	<p>1. Opservacion i fëmijëve nëpër grupe, identifikimi dhe evidentimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në zhvillim</p> <p>2. Punë terapeutike: ushtrime për grafomotorikë, ushtrime për motorikë të vrazhdë dhe të bukur, ushtrime senzomotorike, ushtrime për integritet trupor dhe lateralizim, ushtrime të aparatit të së folurit (në grupe dhe individuale)</p> <p>3. Ushtrime për fryshtim korrigjim me fëmijë të cilët belbëzojnë, flasin shpejtë, pakuptueshëm ose ngadalshëm në mënyrë patologjike, të cilët përfjetojnë bllokada emocionale – fiziologjike, të cilët kanë probleme për shkak mjedisit dyguhësor</p> <p>4. Udhëzim për kontolle specialiste me qëllim të</p>	Gjatë vitit

	<p>kategorizimit të saktë dhe me kohë të fëmijëve me probleme në zhvillim</p> <p>5. Udhëheqje të dokumentacionit për fëmijë: dosje individuale (për evidencë dhe ndjekje të fëmijëve me faktorë rreziku dhe probleme zhvillimore)</p>	
<p><b>Detyra dhe aktivitete në lidhje me prindërit/ kujdestarët</b></p> <p>Qëllimi: Vetëdijesimi i prindërve/ kujdestarëve për nevojën e stimulimit të hershëm dhe nxitjen e zhvillimit të gjithëmbashëm të fëmijëve dhe intervenimi i hershëm në zbutjen e korrigjimit të aftësisë së kufizuar</p>	<p>1. Intervistë dhe anamnezë familjare me prindërit e fëmijëve m pengesa në zhvillimin dhe të folurit</p> <p>2. Ndihmë prindërve/ kujdestarëve në periudhën e adaptimit të fëmijëve në kopshtin</p> <p>3. Njohja e prindërve/ kujdestarëve me problemet dhe vështirësitë të cilat i kanë fëmijët e tyre</p> <p>4. Ofrim i ndihmës për pranimin e problemit të fëmijës dhe bashkëpunimi në periudhën e trajtimit dhe rehabilitimit</p> <p>5. Informim dhe edukim i prindërve/ kujdarëve përfazat e zhvillimit tek fëmijët</p> <p>6. Pjesëmarrje në mbledhjet prindërore së bashku me edukatorët dhe përkëdhelëset (sipas nevojës)</p> <p>7. Mbajtja e evidencës për bashkëpunim me prindërit/ kujdestarët</p>	Gjatë vitit
<p><b>Detyra dhe aktivitete në lidhje me ekipet edukative</b></p> <p>Qëllimi: ndihmë dhe</p>	<p>1. Këmbimi i informatave me ekipet edukative për secilin fëmijë veçanërisht me fëmijët me aftësi të</p>	Gjatë vitit

<p>planifikim në punën profesionale me qëllim të stimulimit të zhvillimit të gjithëmbarshëm si dhe preventivë të çrregullimit e mundshme</p>	<p>kufizuara</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Sigurimi i informatave për fëmijët me aftësi të kufizuara, sjellja në grup me ekipin edukativ dhe fëmijët tjere.</li> <li>3. Këshillim dhe ofrim të ndihmës dhe bashkëpunimi në periudhën e trajtimit dhe rehabilitimit të fëmijës</li> <li>4. Ofrim ndihmë të ekipit edukativ gjatë planifikimit të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe pengesa</li> <li>5. Informim dhe edukim i ekipeve edukative për fazat e zhvillimit tek fëmijët</li> <li>6. Pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit të edukatorëve dhe përkëdhelësve</li> </ol>	
<p><b>Detyra dhe aktivitete në lidhje me ekipin profesional</b></p> <p>Qëllimi: veprim i kontraktuar dhe sinkronizuar me anëtarët e tjerë të ekipit profesional në të gjitha segmentet të procesit edukativo – arsimor dhe zhvillimor veçmas me fëmijë me aftësi të kufizuara, vështirësitet në të foluri- gjuhësore, të zërit dhe zhvillimore</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pjesëmarrje në përgatitjen e mbledhjeve prindërore</li> <li>2. Pjesëmarrje në përpilimin e plan programit vjetor për punën e kopshtit</li> <li>3. Pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit profesional</li> <li>4. Pjesëmarrje në përgatitjen, organizimin dhe realizimin e pranimit të fëmijëve veçmas të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në zhvillim</li> <li>5. Përcaktimin e statusit zhvillimor të fëmijës dhe harmonizimin e anëtarët tjerë të ekipit profesional</li> <li>6. Pjesëmarrje në përpilimin e Raportit vjetor të kopshtit</li> </ol>	<p>Gjatë vitit</p>
<p><b>Detyra dhe aktivitete në</b></p>	<p>1 Lidhja dhe bashkëpunimi</p>	<p>Gjatë vitit</p>

<b>Lidhje me mjedisin më të gjërë</b>  Qëllimi: bashkëpunimi me institucionet dhe profesionistët të rëndësishëm për diagnostik dhe rehabilitim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, vështirësitë në të foluri- gjuhësore, të zërit dhe zhvillimore	<p>me institucionet profesionale dhe të specializuara për realizimin e procesit sa më cilësor edukativo – arsimor dhe zhvillimor dhe avancimin e të njëjtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ministria e punës dhe politikës sociale</li> <li>-Byroja për zhvillimin e arsimit</li> <li>-Enti për shëndet mendor</li> <li>-Enti për rehabilitimin e dëgjimit, të folurit dhe zërit</li> <li>- Lidhja e defektologëve dhe logopedëve</li> </ul> <p>Qendra për punë sociale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Kopshte tjera dhe shkolla</li> <li>-Kabinete private logopede – defektologjike</li> <li>-Shoqata dhe organizata</li> <li>- -----</li> </ul> <p>2. Bashkëpunim me profesionistë dhe profile tjera (mjek, pediatër, ORL, psikolog, psikiatër) të rëndësishëm për diagnostifikimin dhe rehabilitimin e fëmijëve me vështirësi në zhvillim.</p>	
<b>Detyra dhe aktivitete në lidhje me përkryerjen profesionale</b>  Qëllimi: arritja e njojurive të reja me qëllim të përparimit më të madh në punën si dhe mundësi për zbatimin e metodave të reja direkt në punën	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndjekja e literaturës nga sfera e edukimit special dhe shkencave simotra</li> <li>2. Ndjekja e arritjeve profesionale në botë nëpërmjet Internetit</li> <li>3. Vizita e trajnimeve, seminareve, ligjératave, punëtorive, konferencave</li> </ol>	Gjatë vitit
<b>Detyrat dhe aktivitetet</b>	1. Personi administrativ i	Gjatë vitit

<p><b>në lidhje me punën administrative të Kopshtit</b></p> <p>Qëllimi: Ofrimi i ndihmës dhe përkrahja e avancimit dhe funksionimin normal të punës të Kopshtit në tërësi</p>	<p>ditarit elektronik</p> <p>2. Komisioni për pranim të fëmijëve</p> <p>3. Udhëheqje e librit kryesor të kopshtit</p> <p>4. Trupi koordinues për vazhdim dhe përtëritje të licencave</p> <p>5. Tabela vjetore, mujore dhe ditore, statistika, raporte, të dhëna dhe informata lidhur me fëmijët</p>	
---	---	--

### **PROGRAMI PËR PUNË I PUNËTORIT SOCIAL TË INSTITUCIONIT PUBLIK KOMUNAL KOPSHTI PËR FËMIJË “SNEZHANA” PËR VITIN 2020/2021**

Puna e punëtorit social për vitin shkollor 2020/2021 do të organizohet në këtë mënyrë:

- **Pjesëmarrje në aktivitetet organizative** Inkuadrim në mbledhjet e punës, Këshilli profesional, Këshilli i edukatorëve, Këshilli i përkëdhelësve, komisioni për pranim të fëmijëve.
- **Realizimi i trajtimit individual me fëmijët:** detektimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara, njohje, ndjekja e procesit të adoptimit dhe ndarja nga prindërit, ndjekja e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe të fëmijëve të talentuar, vlerësimi i procesit të socializmit, statusi zhvillimor dhe përparimi i fëmijëve, realizimi i aktiviteteve grupore, realizimi i aktiviteteve të cilat kontribuojnë në socializmin e fëmijëve, njohja dhe studimi në bashkëpunim me edukatorët dhe përkëdhelësit, të indikacioneve sociale të cilët e ngadalësojnë ose pengojnë avancimin e grupit edukativ;
- **Bashkëpunim me prindërit :** për komunikim sa më të suksesshëm dhe bashkëpunim, partneritet me prindërit, ndërsa me dëshirë për njohje sa më të mirë të fëmijës dhe nxitjen e zhvillimit të tij, do të zbatohen këto mënyra të bashkëpunimit;
- Takim prindëror me të gjitha grupet edukative dhe të çerdheve, me vënie të theksit të prindërve të fëmijëve të regjistruar të rinj (njohja me programin për punë, orarin e aktiviteteve ditore, informata për qëndrim, pagesë të faturave, mungesa nga kopshti);
- Takim periodik me prindërit të takimeve të përbashkëta me qëllim të njoftimit për planet për punë me fëmijë dhe përfshirjen e prindërve në të njëjtët;
- Takime të mëngjesit dhe konsultime gjatë pranimit të fëmijës në kopsht;

- Takime të pas ditës dhe konsultime gjatë marrjes së fëmijës nga kopshti;
- Vizitë e vendit të punës të prindërit (arritja e njohurisë për profesionin);
- Intervistë e iniciuar me prindërit gjatë regjistrimit të fëmijës në kopsht;
- Plotësimin e fletëve anonime anketuese në fillim dhe në fund të vitit shkollor për ndjekjen e cilësisë së punës edukativo-arsimore dhe përkujdesëse dhe marrje të propozimeve për avancimin e të njëjtëve;
- “Rritimi së bashku” – përkrahja e fëmijëve të moshës 3 vjeçare dhe prindërit e tyre;
- Shëtitje të përbashkëta dhe shoqërimë, me qëllim bashkëpunimi sa më të suksesshëm;
  - dhënie mundësi prindërve që të donojnë gjithçka që do të shërbente për zbulimin e mjedisit në të cilin fëmija e tyre qëndron pjesën më të madhe të ditës;
  - Informimin e familjes për të drejtat e fëmijëve dhe të prindërve në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes sociale. Kryerja dhe zhvillimi i drejtpërdrejtë i punës individuale dhe grupore këshillëdhënëse me prindërit në lidhje me çështjet e shprehura sociale
- **bashkëpunimi:** planifikim grupor i punës edukative arsimore, me drejtorin, edukatorët, pedalin, logopedin dhe bashkëpunëtorin muzikor, lidhja e shërbimeve sociale të komunës me institucionin dhe lehtësimin e fëmijëve dhe prindërve të marrjes efikase të shërbimeve përkatëse nga fushëveprimi i institucionit, varësish nga karakteri i institucionit dhe kushteve për mbrojtje sociale, Pjesëmarrje në punën e ekspertëve multidisciplinor të institucionit, varësish nga karakteri i lëndës së punës, në rastet e problemeve të shprehura dominante sociale, udhëheqje ose koordinim me to, Puna me gjithë familjen dhe kontakte dhe bashkëpunim me institucionet tjera profesionale, organizatat humanitare, sektori civil, sigurimin e ndihmës (e natyrës materiale dhe jo materiale) të fëmijëve të goditur nga gjendja e palakmueshme etj, në bashkëpunim me edukatorët dhe punëtorët tjerë profesional, në rast të adoptimit të vështirësuar të fëmijëve në qëndrim në institucionin parashkollar.
- **Përkryerje profesionale** (mbajtja e punëtorisë, prezantimi dhe edukimi i kuadrit edukativ –arsimor në temë: “Ndjekje eksplore e fëmijëve me pengesa në zhvillim”)
- **Udhëheqja e dokumentacionit pedagogjik** Pjesëmarrje në përpilimin e programit vjetor për punë të institucionit dhe në korniza të saj definimin e programit të punës sociale, udhëheqjen e dosjes për fëmijë, pjesëmarrje në planifikimin e grupeve edukative, në nivel të institucionit si dhe në formimin dhe strukturimin e grupeve edukative. Mbajtja e evidencës për punën e tij, pjesëmarrje në përpilimin e raporteve vjetore për punën e institucionit;

- **Informimin e familjeve për shërbime sociale** të cilët merren me llojet e veçanta të pengesave tek fëmijët ;

Propozim dhe ndërmarrje të formave përkatëse të mbrojtjes dhe shërbimeve të punës sociale për fëmijë individual të cilët jetojnë në kushte të palakmueshme dhe ofrim të ndihmës në realizimin e të drejtave të caktuara në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe sistemin e mbrojtjes sociale;

Përcaktimin e nevojave specifike individuale sociale të fëmijëve dhe puna e zgjedhjes së tyre;

Punën në zbulimin dhe paraqitjen e dhunës familjare dhe keqpërdorimin fizik dhe psikik të fëmijëve të cilët janë përfshirë për kujdes dhe edukim në kopshtin për fëmijë;

Inicim të angazhimit të qendrave për punë sociale në punë me familje individuale të cilët kanë probleme të caktuara;

Puna me tërë familjen dhe kontakte dhe bashkëpunim me institucionet tjera profesionale, organizata humanitare, sektori civil, të sigurimit të ndihmës (të natyrës materiale dhe jo materiale) të fëmijëve të goditur nga gjendjet e palakmueshme etj, në bashkëpunim me edukatorët dhe punëtorët tjerë profesional, në rast të adaptimit të vështirësuar të fëmijëve në qëndrim në institucionin parashkollar;

## PLANI AKCIONAL PËR PUNË TË PUNËTORIT SOCIAL

<b>PËRMBAJTJA E PUNËS</b>	<b>DETÝRAT</b>	<b>KOHA E REALIZIMIT</b>
<b>Programin dhe planifikim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Merr pjesë në përpilimin e programit vjetor të kopshtit</li> <li>- Përpilon program për punën e tij</li> <li>- Merr pjesë në formimin e grupeve edukative sipas moshës</li> <li>- Mbledhje e analizave të të gjitha të dhënavë statistikore të fëmijëve (sipas moshës, gjinisë, kategorisë socio profesionale të prindërve, numri i fëmijëve në familje, fëmijë jashtë martesor, martesor, fëmijë pa prindër, prindër të shkurorëzuar)</li> <li>- Pjesëmarrje në aktivitetet e planikuara për Javën e fëmijëve</li> <li>- Aftësim profesional i kuadrit edukativ për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara në nivel të arsimit iniciues, si dhe përkryerje</li> </ul>	<p style="text-align: center;">Qershori, Korrik, Gusht</p> <p style="text-align: center;">Shtator, Tetor, Nëntor</p>

	<p>profesionale i të njëjtit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i bashkëpunimit sistematik në mes institucioneve të sistemit parashkollar dhe institucioneve profesionale të cilët ofrojnë ndihmë në punën me fëmijë me aftësi të kufizuara për arsyet e zbulimit të tyre në kohë dhe ofrim të ndihmës profesionale.</li> </ul>	
<p><b>Puna e krijimit të kushteve optimale për zhvillimin psiko fizik të fëmijëve dhe puna edukative - arsimore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndihmë instruktive dhe profesionale të kuadrit edukativ –përkujdesës në krijimin e klimës së volitshme për interakcion dhe komunikim fëmijë – fëmijë dhe i rritur – fëmijë.</li> <li>- Pjesëmarrje në organizimin dhe pranimin e fëmijëve</li> <li>- Ndihmë e kuadrit edukativ për mënjanimin e arsyeve të cilët e pengojnë punën në grup</li> <li>- Pjesëmarrje në formimin dhe strukturimin e grupeve edukative</li> <li>- I analizon, ndjek dhe mëson indikatorët social të cilët jepin ose nuk jepin sukses përvaret edukativ</li> <li>- Ndrekja e interakcionit në nivel të grupit (në mes ekipeve edukative) si edhe në mes grupeve</li> </ul>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit</p> <p>Në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit</p>
<p><b>Ndjekja dhe orientimi i zhvillimit të fëmijëve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndrekja e adaptimit të fëmijëve të ri të ardhir</li> <li>- Ndrekja e adaptimit të fëmijëve në grupe edukative varësisht nga mosha</li> <li>- Ndrekja e adaptimit të fëmijëve me pengesë të lehtë në zhvillimin e grupeve të rregullta</li> <li>- Punë instruktive dhe bashkëpunim me edukatorët dhe përkëdhelësit në pranimin e fëmijëve nga familjet jo të plota dhe disfunkzonale</li> <li>- Ndihmë e kuadrit edukativ –përkujdesës në identifikimin e fëmijëve të keqpërdorur dhe shqetësuar</li> <li>- Ndihmë instruktive e kuadrit me qëllim të avancimit të bashkëpunimit me familjen.</li> </ul>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit</p>

<b>Bashkëpunim me familjen</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Punë individuale me prindër individual në pajtim me nevojat</li> <li>- Planifikim i aktiviteteve individuale me fëmijën gjegjësisht familjen nëse kanë çfarëdo nevoje sociale</li> <li>- Ndihmë këshillëdhënëse të familjeve fëmijët e të cilëve kanë vështirësi në zhvillim</li> <li>- Vizitë familjes</li> <li>- Edukim i bashkëpunimit më të afër me prindërit, marrjen e përkrahjes së tyre përendësinë që ka ky aspekt.</li> </ul>	Në mënyrë të vazhdueshme sipas nevojës gjatë tërë vitit
<b>Bashkëpunim me mjedisin më të gjerë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunim me Fakultetin Filozofik</li> <li>- Instituti për punë sociale dhe politikë sociale - Shkup</li> <li>- Angazhimi i qendrave për punë sociale në punën me familjet individuale të cilët kanë probleme të caktuara sipas nevojës.</li> <li>- Dispanzerin për fëmijë</li> <li>- Dispanzerin për shëndet mendor</li> <li>- Organizatat humanitare kryqi kuq</li> </ul>	Në mënyrë të vazhdueshme sipas nevojës gjatë tërë vitit
<b>Përkryerje profesionale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrje në projekte dhe aktivitete profesionale orientuese së bashku me ekipin profesional</li> <li>- Prezantime teorike me tema me karakter social</li> <li>- Pjesëmarrje në seminare, prezantime, trajnime, tribuna dhe përkryerje tjera profesionale ndjekje e literaturës së re profesionale</li> </ul>	Periodike dhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë vitit
<b>Udhëheqje e dokumentacionit dhe evidencës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportet mujore dhe vjetore për realizimin e programit në lëmin e punës sociale</li> <li>- Pjesëmarrje në përpilimin e raportit vjetor për punë të kopshtit</li> </ul>	Periodike dhe Qershori

Aktivitetet punuese punëtori social do ti kryejë në të gjitha objektet e institucionit, nga një javë pune në secilin objekt dhe sipas nevojës në marrëveshje me drejtorin e institucionit. Për kryerjen e detyrave të punës drejtësëdrejti është përgjegjës para të njëjtë.

## **PËR PUNËN E PROFESORIT TË DIPLOMUAR TË GJUHËS DHE LETËRSISË SË HUAJ – BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL I INSTITUCIONIT PUBLIK KOMUNAL KOPSHTI PËR FËMIJË “SNEZHANA” PËR VITIN 2021/2022**

Në kopshtin për fëmijë “Snezhana” jeta dhe puna e fëmijëve është organizuar në dy objekte, në 23 grupe edukative.

Profesori i diplomuar i gjuhës së huaj si bashkëpunëtor profesional, planifikim dhe realizim i punës edukative – arsimore me fëmijët në grupet dhe bashkëpunimi me prindërit, edukatorët, përkëdhelësit, punëtorët profesional dhe bashkëpunëtorët do të realizohet në dy objektet: “Shkurtabiqët” dhe “Fjolla”.

E hënë dhe të martën në objektin “Fjolla”, mërkurë dhe e enje të punës edukative “Shkurtabiqët”, ndërsa të premten sipas nevojave të punës.

Gjatë planifikimit të punës edukative – arsimore niset nga nevojat, interesat, mundësítë dhe aftësítë individuale të fëmijëve, e cila kontribuon për zhvillimin e gjithëmbarshëm të fëmijës dhe arritjen në domene të ndryshme të zhvillimit.

### **Qëllimi i punës**

Varësisht nga mosha e fëmijës, qëllimi bazë është që të krijohet dashuri tek fëmija, të fitohet siguri dhe stabilitet emotiv në procesin e njohjes së të folurit i cili është i ndryshëm, i ri nga gjuha amtare dhe zhvillimi i aftësisë për të dëgjuar, kuptuar dhe përjetimin e gjuhës së huaj si gjuhë e re, zhvillimin e aftësitë gjuhësore si bazë për zhvillimin e identitetit të tyre, njohjen e rëndësisë së gjuhëve dhe kulturat e tjera dhe kulturat e tjera dhe zhvillim i gjuhës në funksion të aspekteve morale-etike dhe kognitive të personalitetit të fëmijëve.

Nëse lejojnë protokollet për shkak të situatës me KOVID 19, punën e tij do ta realizojnë nëpërmjet punës grupore dhe individuale me fëmijët.

**PLANI AKCIONAL I PROFESORIT TË DIPLOMUAR TË GJUHËS DHE  
LETËRSISË SË HUAJ – BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL**

<b>Detyrat</b>	<b>Aktivitetet me fëmijët</b>	<b>Koha e realizimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Adoptimi dhe socializmi i fëmijëve</li> <li>- Kultivimin e dashurisë dhe raportit pozitiv ndaj gjuhës</li> <li>- Njohjen e rëndësisë të gjuhëve dhe kulturave të huaja</li> <li>- Zhvillimi i aftësive gjuhësore si bazë e zhvillimit të identitetit personal</li> <li>- Zhvillimi i aftësisë përdëgjim, kuptim dhe përjetim të gjuhës</li> <li>- Përmirësimi dhe zhvillimi i aftësive intelektuale, komunikuese dhe krijuese tek fëmijët</li> <li>- Aftësimin e fëmijës të mësojë fjalë të reja të cilët tregojnë terme të përgjithshme</li> <li>- Aftësimin e fëmijës që të kuptojë dhe përdorë fjalë të cilët nuk janë të lidhur me situatën e përafërt</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fëmija dëgjon dhe pastaj e përvetëson gjuhën e re letrare</li> <li>- Merr pjesë në aktivitetet për shqiptimin e fjalëve të reja</li> <li>- Fëmija merr pjesë në lojën e pyetjeve dhe përgjigjeve</li> <li>- Merr pjesë në lojëra për krijimin e kombinimeve të tingujve të pazakontë</li> <li>- Merr pjesë në aktivitetet përdallimin e një tingulli të caktuar me ndihmën e intonacionit, duke vazhduar në fillim, mes dhe në fund të fjalës</li> <li>- Fëmija dëgjon terme dhe fjalë të reja në të cilat zbulon informacione me të cilët do të zgjerojë njohuritë e tij</li> <li>- Bën bisedë, tregon çka ka kuptuar dhe mbajtur mend</li> <li>- Përshkruan lëndë konkrete me fjalët e tij</li> </ul>	Gjatë vitit

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i aftësive për njohjen dhe emërtimin e termave nga fotografitë dhe sllajdeve, revistat përfëmijë</li> <li>- Krijimin e klimës pozitive socio-emocionale dhe inkurajimi i fëmijëve për aktivitete kërkimore dhe krijuese</li> <li>- Zhvillimi intelektual, emocional dhe social i fëmijës</li> <li>- Kultivimi dhe pasurimi i krijimtarisë dhe aftësisë së fëmijëve përtë shprehur fjalimin, gjuhën, shprehjen artistike dhe muzikore përmes lojës dhe aktiviteteve të tjera</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Merr pjesë në aktivitetet në të cilat ndërton fjalë, emra objektesh, rroba</li> <li>- Fëmija njihet me lojërat tradicionale gjuhësore</li> <li>- Luan lojëra të roleve të kafshëve</li> <li>- Individualisht shqipton vargje, fjalë të shpejta dhe numëron</li> <li>- Përpilon fjalë të shkurta me tinguj të dhënë</li> <li>- Merr pjesë në aktivitetet në të cilat vëzhgon dhe komenton fotografi</li> <li>- Merr pjesë në aktivitetet ku mësojmë gjuhën përmes lojës dhe kërkimit</li> </ul>	
---	---	--

<b>Komunikimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe bashkësinë</b>	<b>Koha e realizimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunimi me prindin në periudhën e adaptimit të fëmijës në kopshtin e fëmijëve</li> <li>- Informimi i prindit për zhvillimin e fëmijës</li> <li>- Bashkëpunimi me prindërit dhe bashkësinë lokale, ndërtimi i besimit dhe mirëkuptimit</li> <li>- Inkurajimi i mekanizmave të ndryshëm për bashkëpunim me familjen dhe bashkësinë lokale dhe mbështetja e mundësive për të pasqyruar kulturën e tyre në të gjitha aspektet e punës së kopshtit</li> </ul>	Gjatë vitit

<b>Krijimin e mjedisit stimulues për mësim</b>	<b>Koha e realizimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i mjedisit stimulues, dizajnimi i hapësirës, duke respektuar në mënyrë pedagogjike, estetike dhe kreative parimet nga aspekti i shëndetit, higjienës dhe sigurisë</li> <li>- Krijimin e klimës pozitive në kopshtin për fëmijë</li> <li>- Inkurajimi i respektit reciprok dhe mbështetja e punës në grup mes fëmijëve duke promovuar vlera, qëndrime dhe sjellje pozitive</li> <li>- Përdorimi i teknikave dhe stileve të komunikimit në respekt të dallimeve kulturore dhe gjinore që mund të ndikojnë në klimën e grupit</li> <li>- Sigurimi i shfrytëzimit të burimeve, materialeve dhe mjeteve të ndryshme në procesin mësimor</li> </ul>	Gjatë vitit

Zhvillim profesional dhe bashkëpunim profesional	Koha e realizimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i praktikës personale në bazë të ndjekjes së ndryshimeve dhe risive në arsim</li> <li>- Zhvillim dhe zbatim i aftësive reflektuese për analizimin dhe përmirësimin e praktikës personale</li> <li>- Bashkëpunim me kolegët nga shoqatat e ndryshme profesionale</li> <li>- Zbatimi i të gjitha ndryshimeve dhe risive në profesionin personal</li> <li>- Promovimi aktiv i marrëdhënieve kolegiale dhe respektimi i etikës profesionale në lidhje me detyrimet dhe kolegët brenda dhe jashtë kopshtit</li> <li>- Pjesëmarrje në shoqata të ndryshme profesionale, rrjetet sociale, forumet me qëllim që të përmirësohet puna individuale.</li> </ul>	Gjatë vitit

Деловоден број/ Numri i protokollit      0102 – 441

Датум / Data      24.09.2021

Drejtore,

Daniela Kostencova

Literatura e shfrytëzuar:

1. "Programi për mësim dhe zhvillim të hershëm" bazuar në Standardet përmësim dhe zhvillim të hershëm, miratuar nga Ministria e punës dhe politikës sociale "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 22/13 dhe 22/14
2. „*Projekt – programi për zhvillim të edukimit dhe arsimimit parashkollar*“, Programi nacional për zhvillim të arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2005 – 2015: Qershori 2005;
3. *Children in Europe (2008). Schools for the 21- st Century – Analysis of Public Consultation.* Ec.europa.eu/education/school21/results/report\_en. Pdf
- 4 *Children in Europe (2008). Young Children and Their Services - Developing a European Approach. A Children in Europe Policy Paper.* www.childreninerope.org
5. www.issa.nl
6. www.programi.com
7. Doracak „Si të bëhesh eko – shkollë /Kopsht. Shkup – OHO, 2008
8. *Doracak për respektimin e divergjiteteve dhe multikulturalizmit në zhvillimin e hershëm të fëmijës – Ministria e punës dhe politikës sociale, Republika e Maqedonisë së Veriut*